




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e shtatë (VII) të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, më datë 27.5.2014. 2014 me këtë:

REND TË PUNËS

- 1 Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2 Betimi i anëtarëve të rinj të kuvendit
Emërimi i Nënkryetarit të Komunës për Komunitete
- 3 Zgjedhja e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete
- 4 **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 4.1 Propozim Rregullorja mbi përgjegjësin disiplinore dhe materiale të punonjësve në institucionet edukative arsimore dhe aftësuese në Komunën e Gjiçanit
 - 4.2 Plani i veprimit për përmbushjen e transparencës në Komunë
 - 4.3 Propozim vendimi mbi qasjen e PDU: "Qendra-pjesa veriore e Qytetit, "Kodra e Dëshmorëve" dhe Nën Kodra e Dëshmorëve" në Gjiçan
 - 4.4 Propozim Vendimi mbi qasjen e revidimit të PDU: "Zona Perëndimore-Qarku" në Gjiçan
 - 4.5 Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të PRR të hollësishëm: "Fidanishte" në Gjiçan
 - 4.6 Kërkesë e DAP-it për bartjen e shpenzimeve postare të pilot projektit "HOME KOMUNA-APLIKU ONLINE"
 - 4.7 Konstituimi i Komitetit dhe themelimi i Zyrës për të drejtat e shqiptarëve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit.
- 5 Të ndryshme
Seanca i filloi punimet në ora 10.15 min

Në punimet e seancës së shtatë morën pjesë;

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri

Zv/kryetari i Komunës, z. Rexhep Kadriu

Përfaqësuesi i të Drejtave të Njeriut, z. Fazli Abdullahu

Përfaqësuesi i OSB-së, Basri Sejdiu

Mediet

Seancën e shtatë të kuvendit të Komunës e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesja e Kuvendit zonja Valentinë Bunjkau – Rexhepi e cila fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, zv/kryetarin dhe të gjithë të pranishmit e tjerë të cilët e monitorojnë

punën e seancës së Kuvendit dhe mediet. Së pari kërkoj nga sekretari që ta verifikojë prezencën e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë?

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e seancës së shtatë ishin prezent 34 anëtarë, kurse mungoi 1 (një)- Sergjan Mitroviç

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- ka forum për të vazhduar me punë, kurse sa i përket rendit të punës materialin e keni marrë me kohë, prandaj nëse ka dikush ndonjë vërejtje mund ta merr fjalën.

Renan Imam- propozoj që pika 3 e rendit të punës duhet të hiqet, sepse ende nuk e kemi arrit koncenzuesin me partinë në pushtet.

Aprovohet propozimi i z. Renan Imam me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët nuk u deklaruan për asnjë variant të votimit.

Sahit Abazi- përveç këtyre pikave të rendit të punës, ne kërkojmë që të debatohet me drejtorin e Arsimit për shqetësimet që janë shfaqur te mësimdhënësit e shkollave të mesme, sidomos të shkollave profesionale. Ekziston një shqetësim mjaft i madh tek mësimdhënësit e shkollave profesionale, sepse do të mbesin një numër i konsideruar i mësimdhënësve pa punë për shkak të reduktimit të numrit të klasave.

Pyetja tjetër është për drejtorin e Zhvillimit Ekonomik për shkak të dështimit të Konferencës së Donatorëve, prandaj edhe për këtë kërkojmë informacion?

Nevzad Isufi- unë edhe në mbledhjen e KPF-së kam kërkuar që të futet në rend pune çështja e ndërtimeve pa leje e cila temë ka qenë deshtë të jetë si temë debati edhe sipas Planit të punës së Kuvendit.

Bujar Nevzadi- i përshëndes të gjithë e veçanërisht e përshëndes kryetarin e Komunës , sepse pas një kohe të gjatë ka vendos që të jetë i pranishëm në seancë dhe shpresoj se do të qëndrojë deri në fund për ta dëgjuar zërin e kuvendarëve.

E para kam vërejtje tek kryesuesja e cila fillimisht nuk po lejon që të shterret debati lidhur me rendin e punës, prandaj duhet respektuar Rregulloren.

E dyta keni bërë shkelje ligjore, sepse nuk e keni thirr pas 7 dite të mbajtjes së KPF-së seancën e KK-së, kurse në anën tjetër thirrreni në ligj edhe gjatë fushatës, por edhe tash, por në anën tjetër vetë kryetari po i shkel ligjet. Mandej i keni heq pikat e rendit të punës të cilat vet i keni propozuar në KPF.

E treta kemi kërkuar listën e të punësuarve në Administratën Komunale që nga 24 dhjetori , të cilën listë keni pasur për obligim për ta sjell këtu.

E treta ka qenë obligim që të silllet këtu lista e projekteve të realizuara për t’ i treguar kuvendarëve se çka keni punuar?

E katërta në komitet kemi votuar që të në rend pune të futet si pikë debati: ndërtimet pa leje!

Për të gjitha ato që jemi marrë vesh në komitet kërkoj që të futen në rend pune.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- listën e të punësuarve dhe të projekteve do ta merrni me shkrim, prandaj vetëm iu duhet durim, sepse do të japim përgjigje, kurse tash jemi tek rendi i punës, kurse listën e të punësuarve iu japim juve dhe tërë grupit.

Imet Rrahmani – unë nën të ndryshme i kam dy shqetësime të qytetarëve; një është përkitazi me parkingjet në Lagjen “Arbëria” dhe një që ka të bëjë lidhur me zbatimin e Rregullores së KK-së për veprimtarinë e bizneseve private në orët e mbrëmjes.

Avdyl Aliu- lidhur me ndryshimin e rendit të punës ne jemi marrë vesh që ta bëjmë këtë ndryshim dhe për ta bërë emërimin e zv/kryetarit dhe zv/kryesuesit për komunitet e që qëllimi ka qenë për ta funksionalizuar punën e Kuvendit. Mirëpo komunitetet përkatëse ende nuk kanë gjet mirëkuptim, prandaj ne nuk mund të veprojmë kundër dëshirës së tyre.

E dyta lidhur me afatin ligjor të seancës është diçka shumë e qartë, sepse ne kemi pasur një marrëveshje në KPF për ta mbajtur seancën më 27 maj dhe jo më 28 për shkak se më 28 maj fillon fushata parazgjedhore.

Leonorë Bunjaku- në pamundësi të marrjes së fjalës nga ana e kryesuese para dy seancave dhe në mungesë të kryetarit të Komunës unë sot po e marrë fjalën.

Çështja për të cilën do të flas sot ka të bëjë me problemet e fundit në Shkollën e Artit Pamor.

Unë Leonorë Morina –Bunjaku - kam kërkuar sqarime lidhur me mos mbajtjen apo pengimin e procesit edukativo-arsimor, por edhe kam kërkuar sqarime lidhur me problemet dhe akuzat për skandale seksuale. Këtë gjë e kam dëgjuar edhe në TV “Klan” nga një nxënëse e të njëjtës shkollë. Mirëpo kryetari e thotë se ka skandale seksuale, mandej vazhdon drejtori i Arsimit duke kërkuar nga ana e ime emrat e atyre që kanë bërë gjëra të tilla, ose në të kundërtën do të më padisin në Prokurori. Mirëpo ka të bëjë me një shpifje, shantazhë, pasi që edhe vetë e keni pranuar se dhe përkundër problemeve në zgjidhjen e këtyre problemeve nuk keni pasur sukses. Po deklaroj se unë mbaj përgjegjësi të plotë për fjalën të cilën e kam thënë e jo për atë se si ju e keni kuptuar ose keqinterpretuar. Shkrimi është publik dhe unë bazohem në argumente të këtij shkrimi.

Fehmi Sylejmani- dëshiroj që kjo seancë të jetë seancë e mirëkuptimit dhe të ec puna mbarë edhe pse jashtë është vapë, dëshiroj që këtu të jetë pak më freskët. Unë po e vërej se këtu jemi për të debatuar dhe t’i ngrisim të gjitha çështjet që na brengosin dhe i preokupojnë edhe qytetarët, por unë kërkoj mirëkuptim nga të gjithë anëtarët në dy pikat të cilat do t’i propozoj e të cilat të jenë pika të përhershme të këtij Kuvendi.

E para është deklarimi jashtë rendit të punës –kjo të jetë çdo herë në rend pune në çdo seancë. Çështje tjetër të ketë pyetje kuvendare për ekzekutivin dhe nga ana e jonë të kemi mundësi t’i drejtohem qoftë kryetarit, qoftë drejtorëve me nga një apo më tepër pyetje.

Lutfi Haziri- pasi që u apostrofova disa herë, më lejoni t’i jap sqarimet sa i përket rolit tim si kryetar dhe ekzekutivit të cilin unë e udhëheq. Pasi që jemi në fazën e ndryshimit të statutit jam i gatshëm që nëse pajtohen grupet e këshilltarëve të normohet çështja e deklarimeve kuvendare dhe pyetjeve kuvendare. Unë jam i interesuar për ta normuar në mënyrë që të kemi komunikim dhe të kemi parashtresa, kërkesa dhe natyrisht ta kemi një renditje të cilën të zgjedhurit e qytetarëve siç jeni ju të komunikojmë në raporte zyrtare dhe raporte të përditshme. Unë po e marrë propozimin e këshilltarit Sylejmani me pëlqimin e të tjerëve për ta normuar këtë çështje.

Gjithashtu ne jemi edhe më tutje në fazën e vlerësimit të rrudhjes së Administratës dhe në shpalljen menaxheriale që përfshin të emëruarit politik. Shërbimi civil edhe më tutje ka

probleme, sepse duhet të jetë në përputhje me shërbimin që jep Gjilani, por vendimi i Qeverisë nuk mund të ndryshohet për shkaqe buxhetore.

Sa i përket Shkollës së Artit Pamor, është çështje e tejkaluar, është stabilizuar gjendja, por subjekt i hetimeve janë të gjithë ata që janë përfshirë në këtë problem dhe i takon Prokurorisë për ta konstatuar këtë problem. Unë i lus të gjithë ata që kanë informata të bashkëpunojnë me prokurorë dhe ta zbardhin këtë rast. Ne si të zgjedhur duhet të kemi kujdes në deklarata, sepse nuk mund të kontribuojmë nëse e rëndojmë situatën. Kërkesa e shkollës e nxënësve e Këshillit të prindërve dhe një numrit të arsimtarëve ka qenë që të ndërrohet menaxheri i shkollës dhe të vendoset një rend më i mirë i komunikimit në mes të palëve në mënyrë që të ketë kontribut në arsim. Tash konkursi është i hapur dhe do të zgjidhet një drejtor i ri dhe do ta dërgon misionin përpara.

Sa i përket kërkesave tjera edhe listës së shërbyesve civil, sepse nuk ka të punësuar tjerë në Administratë edhe lista e ndërtimeve pa leje në dy faza edhe listat e tjera do të procedohen me shkrim ose do t' i sjellim në seancë sipas kërkesës së juaj. Për të gjitha çështjet të cilat dëshironi për t' i diskutuar ne jemi të hapur, por duhet ta bëjmë një rrugë të vendosjes së rendit në mënyrë që seancat të thirren sa herë ka nevojë dhe jo vetëm njëherë në muaj.

Letrat janë dhe mund të gjenden dhe mund të gjenden në online, sepse janë të trashëguara në sirtare të Komunës, por edhe projektet janë e të cilat nuk kanë ndryshuar, por ne mendojmë se duhet të ndryshohen në Kuvend. Lista e projekteve dhe agjendën komunale duhet ta miratojë Kuvendi.

Arben Maliqi- unë do ta bëj një apel në pikën të ndryshme për të gjithë anëtarët e Kuvendit, por edhe për subjektet politike të Komunës së Gjilanit që të reflektojnë pozitivisht te qytetarët dhe kërkoj që nën të ndryshme të më epet rasti.

Bujar Nevzadi- unë përsëri kam pyetje për kryetarin, sepse jam i sigurt se kryetari nuk rrinë deri në fund të seancës! Kërkoj ta di se ku banon kryetari? Ku mësojnë fëmijët e kryetarit?

Kryetari nuk banon te Derë Mahalla ashtu si po deklaron! Pse veturës zyrtare ia ka hequr logon e Komunës? Në sa e fillon kryetari i Komunës orarin e punës?

Mandej Nezihate Agushi është nënkryetare e forumit të gruas, kurse në komiteti ka shkuar si anëtare e partisë turke, pse ka ndodhur kjo? Kryetari i Komunës të jep përgjigje të qarta, sepse nuk ka se çka të fsheh dhe ta thotë të vërtetën se banon në Prishtinë.

Lutfi Haziri- edhe pse me rregullore nuk shihet pyetje përgjigje, këto gjëra po bëhen, por këto pyetje më duket se janë të natyrës së policisë dhe të logjikës së hetimeve! Duke e pasur një përvojë të rëndë në këtë aspekt, pyetjeve të tilla nuk mund t' i përballojë edhe 15 vjet pas përfundimit të luftës, pyetjeve të tilla. E para që nga pas lufta asnjëherë nuk jam ndarë nga Gjilan dhe çdo herë kam qenë votues në çdo zgjedhje në Gjilan, banoj në Gjilan në rrugën "Mulla Idrisi" nr. 186. jetoj që nga viti 1970 në atë rrugë në atë lagje dhe në atë tokë!

Bujari më njeh mirë, sepse kemi miqësi dhe ma njeh shumë mirë familjen. Fëmijët e mi nuk shkojnë në shkollë jashtë shtetit, por shkojnë në shkollë të Kosovës dhe janë shkollë publike. Gjithçka tjetër që pretendohet për të nxjerr jashtë të qenit gjilanas është tendencioze dhe është e tepërt për t' u përgjigj në kohë në të cilën po jetojmë!

Në sa e filloj orarin e punës dhe në sa e përfundoj e dinë zyrtarët e Komunës dhe të gjithë shërbyesit civil me të cilët punoj çdo ditë. Unë mendoj se nuk ka një orar të punës për

një kryetar të zgjedhur, por ka një mision dhe ka një program që duhet të zbatohet. Fillimisht ai program nuk mund të zbatohet as për 24 orë. Mirëpo unë e di të qenit komod në opozitë dhe ka mundësi për të menduar shumë dhe për të gjetur shumë probleme. Mirëpo problemet zgjidhen me angazhim dhe profesionalizëm. Nëse mendojmë çdo ditë t' i qesim dikujt lakun në fyt për ta zënë keq dikë dhe ta zëmë gabim, njeri pa gabime nuk ka, sepse vetëm zoti i madh është i pagabueshëm. Unë nuk i përjashtoj asnjëherë gabimet që ndodhin në Administratë. Po përsëris edhe njëherë që nga 24 dhjetori nuk jam marrë me asnjë proces që Administrata e kaluar i ka kaluar në qeverisje dhe as nuk e kam ndërmend të merrem. Unë po e shoh se ka një tendencë për t' u fsheh pas gishtit tregues, por unë nuk e kam ndërmend të merrem me këto gjëra, nuk është punë e imja. Nëse duam të shtyhem me fjalë dhe letra, atëherë ato janë shenja të këqij, por çka është ligjore dhe çka është detyrë zyrtare sipas ligjit, natyrisht se do ta bëjmë bashkë. Unë nuk jam i obliguar të përgjigjem për motive personale, kurse ato politike nuk i përjashtoj dhe iu lus mos i personalizoni gjërat!

Pas fjalës së kryetari, kryesuesja i liron anëtarët e Kuvendit 5 minuta në pushim

Sahit Abazi- pyetje për kryesuesen a ka të drejtë secili anëtarë i Kuvendit të bëjë propozime?

Riad Rashiti- së pari zonja kryesuese i ka mbi 30 kërkesa me shkrim për kryesuesen dhe drejtoritë dhe asnjë përgjigje nuk e kam marrë! Kërkoj tash përgjigje pse nuk na përgjigjeni në pyetjet tona? Pyetja e parë është për drejtorin e Zhvillimit Ekonomik që të na ep përgjigje se deri kur është arrit rreth zbatimit të projektit të Lumit Mirusha?

E dyta kërkojmë përgjigje lidhur me një marrëveshje private në mes Komunës dhe kompanisë e cila e ka përfunduar një projekt në hapësirat e varrezave të Gjilanit. Këtu ne e kemi dëshminë se është kryer projekti para kohës, para nënshkrimit të kontratës. Mandej kam pyetje për kryetarin e Komunës? Pse e ka shkarkuar Komisionin Komunal për ankesa e të cilin e ka formuar vetë?

Nën tre pse vazhdon të shkelet Ligji i prokurimit dhe pse lejohet të shkelet Ligji për shërbyesit civil të cilin komision e ka shkarkuar për pa u bazuar në ligj dhe në kuadër të kësaj pyetje është pse nuk e ka respektuar LVL-në dhe nuk i ka kthyer në vend të punës zyrtarët politik të cilët kanë qenë në mandatin e kaluar qeverisës?

Valentinë Bunjkau –Rexhepi – kërkesat të cilat na i keni dërguar në adresat e tona, përgjigjet do t' i merrni me shkrim!

Fatbardhë Selmani- kërkoj sqarim nga kryetari i Komunës pse është larguar nga pozita drejtori i QKMF-së i cili nuk ka marrë asnjë vërejtje me shkrim, mandej auditori nuk ka gjetur asnjë shkelje ligjore dhe procedurale dhe përderisa pozita e drejtorit në QKMF sipas Ligjit për shërbyesit civil neni 12 ka qenë drejtor i karrierës e që do të thotë ka qenë i emëruar për një kohë të pacaktuar. Për çfarë arsyeje është larguar drejtori me një vendim qesharak gjëja me një arsyetim të riorganizimit të brendshëm. Ky është një arsyetim qesharak, sepse drejtori nuk ka marrë asnjëherë asnjë vërejtje për mos efikasitet në punë. Në çka është thirr kryetari të cilin e ka shkarkuar atë nga pozita e drejtorit dhe e keni emëruar kryeshef, kurse koeficientin e pagës e ka të njëjtë. A nuk është kjo shkelje ligjore e juaj, sepse dihet se pozita e drejtorit dhe kryeshefit nuk janë të njëjta.

Mandej kërkoj informatë nga kryetari i Komunës, sepse ka premtuar se do të lirohet objekti i kryeartit të Komunës për Muze të qytetit, por kjo nuk po ndodh edhe pas 5

muajve të ardhjes së tij në pushtet. Pyetja tjetër është se janë afër 500 qytetarë të regjistruar për një takim prej 2 minutave me kryetarin, por ende nuk janë takuar, kurse kryetari thirret se është i hapur në çdo kohë për qytetarët?

Bujar Nevzadi- kjo po flet mjaft, sepse me çdo kusht po mundoheni për ta ngulfat debatin. Unë nuk e di pse kryetari po e vë veten në atë pozitë! Nëse dikush nga kjo sallë mund të ma thotë se kryetari banon në Gjilan, unë kërkoj falje dhe jap dorëheqje nga pozita e asamblistit. Nëse fëmijët e kryetarit e thotë dikush se mësojnë në shkollat e Gjilanit le ta thotë, prandaj le t' i len llafet dhe deklaratat e mëdha.

Nevzad Isufi- disa fjalë për bursat e studentëve, sepse ka studentë të cilët ende nuk i kanë marrë bursat, prandaj të jeni më efikas, sepse nuk është e logjikshme që bursat të epen pas përfundimit të vitit akademik. Kërkoj që kjo çështje të jetë si agjendë urgjente dhe pagesa e bursave të bëhet sa më parë.

Lutfi Haziri- unë vazhdimisht po thirrem në disa çështje të cilat kanë të bëjnë me ekzekutivin, por ka çështje të cilat kërkojnë për t' u përgatitur e sidomos ato të cilat kanë të bëjnë me Zyrën e Prokurimit. Ajo që është serioze dhe e çmoj është angazhimi për fillim të kursimeve, ajo që nuk mund ta çmoj dhe përfundimisht bëj thirrje që askush mos të sillet nga familja ime dhe fëmijët e mi! Kjo është e tepërt dhe çdo kush e dinë se familja është e shenjtë. Askujt dhe kurrë nuk ia kam përmendur familjen dhe duhet përmbajtje në politikë dhe mos të hyhet aty ku nuk duhet. Familja është e shenjtë dhe atë duhet mbrojtur, por nëse dikush e thotë se që nga 24 dhjetori Lutfi Haziri nuk jeton në shtëpinë e vetë në Gjilan unë jap dorëheqje nga kryetari i Komunës.

Sa i përket QKMF-së është riorganizim me vullnet të plotë, kurse e imja ka qenë vetëm për ta bërë aktin formal. Sa i përket komisioneve tjera edhe në debate jam i gatshëm për t' u përgjigj.

Valentinë Bunjkau –Rexhepi- ju lutem të deklaroheni kush është për këtë rend të punës?

Aprovohet rendi i punës me 32 vota të anëtarëve të Kuvendit

Aprovimi i procesverbalit

Avdyl Aliu- vazhdimisht po na përcjelljen disa gabime teknike dhe jo teknike në procesverbal dhe procesverbali duhet ta reflektoj situatën reale si ka qenë në seancë. Vërejtjet janë se nuk ka nevojë të dallohen anëtarët e KK-së dhe nuk ka nevojë dikujt t' i shkruhet diskutimi me shkronja të mëdha, kurse dikujt me të vogla. Dikush e ka tërë diskutimin, kurse diku është cunguar!

Aprovohet procesverbali me këtë vërejtje, me 34 vota të anëtarëve të Kuvendit.

2. Betimi i anëtarëve të rinj të Kuvendit

Betimin solemn para anëtarëve të Kuvendit e jep Rina Ahmeti, sepse Florinë Jerliu është tërhequr nga pozita e anëtares së Kuvendit.

3. Zgjedhja e Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete

Pika e tretë e rendit të punës është hequr nga debati me kërkesë dhe pëlqim të anëtarëve të Kuvendit.

4. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

4.1 Propozim Rregullorja mbi përgjegjësin disiplinore dhe materiale të punonjësve në institucionet edukative arsimore dhe aftësuese në Komunën e Gjilanit

Mevlyde Zejnullahu –ka qenë shumë e nevojshme një rregullore, sepse është një dokument që i normon rregullat dhe përgjegjësit e punëtorëve të arsimit. Kjo rregullore është mjaft e mirë dhe e hartuar në bazë të ligjit të punës, mirëpo në draftin e kësaj rregulloreje unë i kam disa vëreje dhe sugjerime. Mendoj se më mirë do të ishte të thirremi në nenin 95 të Ligjit të punës se sa në nenin 85 dhe 86 të këtij neni, sepse neni 95 na obligon për të nxjerr rregullore, kurse neni 85 dhe 86 nuk përfshihet apo nuk përmenden institucioni për të cilin po flasim

Unë i kam edhe disa vërejtje në disa nene e të cilat janë: te neni 3 pika 1.10, përveç fjalës “shpifje” duhet të shtohet e edhe fjala “fyerje”. Pika 2.4 të theksohet se ndalohet mbajta e kurseve në objekte shkollore apo edhe jashtë objekteve shkollore?

Te neni 7 pik 2, thuhet vërejtje me gojë, por mungon edhe fjala me “shkrim”. Në nenin 11, duhet shtuar edhe “Pranë Drejtorisë së Arsimit”. Te neni 14, pika e parë ku thuhet: “autorizon me vendim një komision” të specifikohet se çfarë komisioni (i ankesave), pranë Drejtorisë së Arsimit. Gjithashtu edhe te neni 15 duhet të shtohet fjalia: “Komisionit të ankesave”. Ju faleminderit për mirëkuptim.

Nevzad Isufi- kjo rregullore është e një rëndësie të madhe, por ne dëshirojmë që të kontribuojmë dhe të bëhen edhe disa përmirësime dhe mendoj se te neni 1 ku thuhet :“me këtë rregullore, rregullohet”, do të ishte më mirë të thuhet të “përcaktohet”.

Neni 3 pika 1.6 thuhet: “pengon nxënësit” , por mendoj se duhet të jetë” pengimi i nxënësve ...” Në KPF është thënë se togfjalëshi “mungesat e tepërta “ duhet të korrigjohet dhe thuhet numri i madh i mungesave etj. Te pika 2.4 të cilën vërejtje e dha zonja Zejnullahu te mbajtja e kurseve nëse hyn në kuadër të shkeljeve të rënda, atëherë do të kemi shkelje të tilla çdo ditë dhe çdo çast. Ky nen duhet të formulohet më mirë dhe precizohet ashtu si duhet dhe të jetë: “ mbajtja e kurseve me nxënës me të cilët mësimdhënësi mban mësim të rregullt”. Do të thotë ai mësimdhënësi që mban mësim të rregullt, nuk ka të drejtë të organizojë kurs me ata nxënës dhe duhet të konsiderohet shkelje e rëndë. Mandej duhet të precizohet se kurset duhet të jenë regjistruara dhe të paguhet tatim, por edhe duhet plotësuar kushtet si hapësira dhe të posedojë mjetet mësimore për mbajtje të kurseve, por edhe programet e punës për kurse.

Pika 2.10, ku thuhet: “ keqpërdor mjetet financiare” duhet të jetë :” shpërdorimi i mjeteve financiare”. Pika 2.11 thuhet: “nuk i kryen “, duhet të jetë: “mos kryerja me kohë e obligimeve” dhe duhet të plotësohet në hartimin e planeve, vjetore, mujore...” Pika 2.12, “nuk i respekton” është në veten e tretë , por duhet të jetë: “mos respektimi i Rregullores së shkollës”. Unë konsideroj se mos bartja e uniformës duhet përjashtuar nga shkeljet e rënda serioze, sepse me ligj nuk parashihet uniforma, por kjo normohet me rregullore të shkollës dhe duhet të jetë shkelje e lehtë dhe jo e rëndë!

Te pika 2.14 në fillim të neni duhet thënë: “mos respektimi” dhe jo “nuk respekton”, po ashtu është edhe te pika 2.15, jo “refuzon”, por “refuzimi” ose “mos kryerja e trajnimeve”

Pika 2.16 përsëri duhet të jetë:” refuzimi i kujdestarisë ditore...”. Pika 2.17 duhet të formulohet ky nen më mirë dhe të thuhet:” organizmi i protestave dhe nxitja e ...” do të thotë duhet të jetë në shumës. Gjithashtu edhe në pasuesin e dytë të këtij neni :”shkakton pengesa në mbarëvajtjen e procesit mësimor”, duhet të jetë : “shkakton pengesa në mos

mbarëvajtjen e procesit mësimor”. Në pasuesin tjetër duhet të jetë” veprimeve dhe mos veprimeve, sepse edhe me mos veprimi dëmtohet imazhi i shkollës”.

Neni 5 – thuhet : “parimi i drejtësisë” dhe nëse shkohet me parime, fjala parime duhet të jetë pjesë e çdo pike të ky nen dhe nëse jo atëherë mund të jetë drejtësia.

Gjithashtu duhet përmirësuar një fjalë të cilën duhet përmirësuar është jo punonjësi, por punëtori. Gjithashtu te neni 30 patjetër duhet bërë përmirësime, sepse neni si i tillë është mjaft konfuz dhe jo i renditur mirë.

Avdyl Aliu- kjo është një rregullore të cilën e kemi pasur objekt trajtimi edhe në KPF dhe e kemi thënë se është një bazë e mirë për një punë të mirë të drejtorisë dhe siguron një punë të mirë. Unë e kam një vërejtje është te shkeljet e rënda serioze e që është pika 2.7 dhe thuhet” si shkelje serioze konsiderohet ruajtja e sekretit profesional në punë”. Mirëpo unë KPF kërkova që të përmirësohet kjo, sepse duhet të jetë “mos ruajtja” dhe jo “ ruajtja. ” Mirëpo tash po e shoh se kjo qenka eliminuar në tërësi, por kjo duhet të ekzistojë dhe të jetë ‘mos ruajtja e sekretit profesional në punë”.

Selami Xhemajli- unë vërejtjet e mia i kam paraqitur edhe në KPF dhe konsideroj se ato vërejtje të merren parasysh për të mos i përsërit edhe njëherë në këtë Kuvend. Ne në parim mbështesim këtë rregullore me vërejtjet që i kemi dhënë në KPF dhe me ato vërejtje që i dhanë kolegët?

Arben Maliqi-kjo është një rregullore që ia vlen për ta miratuar dhe përgjegjësia më e madhe ne bie neve mësimdhënësve të cilët punojmë me nxënës. Nëse ne jemi në nivel dhe nëse e kryejmë punën ashtu si duhet edhe fëmijët dhe nxënësit do të jenë ashtu siç duhet. Unë kërkoj që në këso raste kur është kryetari i Komitetit është mirë që ai ta merr fjalën dhe në këtë rast tek është kryetari Arben Mehmeti dhe ai ka qenë desh ta merr fjalën. Nëse është kryetari i komitetit përkatës, ai duhet ta jep një sqarim të shkurtër në mënyrë që ne të hapim debat. Unë po fokusohem te shkeljet e rënda serioze, sepse ky është një problem i madh i cili po ndikon me të madhe për të keq! Është fjala te neni 2.4 ku bëhet fjalë për mbajtjen e kurseve. Ky nen duhet sqaruar, kurset duhet të mbahen, por duhet të mbahen me nxënës me të cilët arsimtari nuk jep mësim. Kjo duhet të normohet, sepse me nxënësit me të cilët arsimtari jep mësim dhe mban kurse ata nxënës po vlerësohen me nota më të larta dhe pati sukses ose nuk pati ai notën e ka 5 (pesë). Është mirë të precizohet që arsimtari me nxënës të cilëve iu jep mësim që mos të ketë të drejtë të mbajë kurse. Kjo për mua është primare dhe me shumë rëndësi.

Shukrie Rapuca- edhe ne në emër të grupit kuvendar të PDK-së e mbështesim këtë rregullore me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që u dhanë. Ne e kemi debatuar këtë rregullore edhe në Komitet të Arsimit dhe i kemi dhënë disa vërejtje e për të cilat jeni të njohur. Edhe unë i bashkëngjitëm mendimit të kolegëve lidhur me shkeljet e rënda e që një ndër to është mbajtja e kurseve. Ka shumë raste kur mësimdhënësit mbajnë kurse me nxënësit e vetë dhe praktikat po tregojnë se po paraqiten shumë probleme dhe duhet të normohet më mirë me këtë rregullore çështja e mbajtjes së kurseve.

Leonorë Bunjaku- unë pasi që jam anëtare e Komitetit të Arsimit e mbështes këtë Rregullore e cila është përpiluar dhe tani duhet ta marrim vendimin për fuqizim të saj. Unë i mbështes të gjitha propozimet nga ana e profesor Isufi dhe të tjerëve, sepse ka të bëjë me kurse dhe anashkalimin e nxënësve. Mirëpo fillimisht duhet të kemi parasysh se

shumë mësimdhënës e kanë mundësinë e mbajtjes së kurseve, por duhet të kemi kujdes në atë se çfarë kushte sigurohen, në çfarë objekti mbahet kursi dhe a janë ato kurse të licencuara dhe të akredituara?

Mundësia e mbajtjes së kurseve ekziston, por duhet të kryhen edhe obligimet ligjore si pagesa e tatimit, licencimit akreditimit dhe kështu me radhë.

Arben Mehmeti- unë pajtohem me atë konstatimin e Arben Maliqit se ka qenë desh ta merr fjalën kryetari i Komitetit, sepse ajo ka qenë praktikë e kaluar, por të cilën kisha desh për ta ndryshuar tash, sepse komiteti është pjesa e fundit e deklarimit për një çështje të caktuar. Mandej për shkak të asaj se po shihet nga praktika se ne si komitet i Arsimit e kemi pranuar një rregullore e cila ka ardhur nga DKA dhe që rregullon fushën e arsimit dhe nuk jemi lëshuar shumë në çështje të kësaj rregulloreje, sepse kjo është kompetencë e DA dhe ne e kemi rekomanduar për aprovim në Kuvend. Mirëpo nga deklaratimet e anëtarëve të Kuvendit po na del pak më ndryshe dhe kemi shumë propozime të tjera. Pasi që tash jemi në përfundim të vitit shkollor, unë jam për atë që edhe këto propozime që u dhanë të jenë pjesë e kësaj rregulloreje dhe të modifikohet me propozime konkrete, pastaj të vijë në Komitetin për Arsim dhe pastaj të vijë për aprovim në Kuvend, sepse nuk është asgjë urgjente. Është mirë që DA aty ku ka sugjerime të vlerësohen dhe të inkorporohen në rregullore dhe mandej Komiteti i Arsimit është i fundit që rekomandon për aprovim në Kuvend.

Nazmi Musa-iu falënderoj të gjithëve për kontributin që e keni dhënë për sugjerime dhe vërejtje që i dhatë për këtë rregullore e cila padyshim është shumë e rëndësishme. Kjo rregullore është hartuar nga komisioni i ekspertëve (juristëve) të cilët pastaj e kanë debatuar në debate publike, mandej në Komitet të Arsimit dhe në KPF. Në aspektin teknik dhe gjuhësor me siguri ka ndonjë gabim teknik, por nga aspekti juridik dhe domethënia e fjalisë dhe formulimi i tyre ajo është kompetencë e juristëve e të cilët duhet ta harmonizojnë rregulloren në bazë të ligjit. Unë mendoj se çdo rregullore e cila debatohet në një forum kaq të gjerë, natyrisht se gjithmonë do të ketë vërejtje dhe nëse shkohet në zhagjitje për shkak të vërejtjeve të tilla, atëherë kam frikën se do të mbesim pa një rregullore duke e shtyrë vazhdimisht kohën. Nga ajo që la mbresë nga folësit paraprak është ajo për çështje të kurseve e cila dukuri është e evidente, sepse në çdo rrugë ka lokale ku mbahen kurse, mandej edhe me nxënësit të cilëve iu jep mësim vetë arsimtari. Kjo praktikë duhet të ndërpritet për shumë arsyeje. E para nuk është etike dhe këtu duhet të involvohen edhe inspektorët, mandej Administrata Tatimore edhe regjistrimi i kurseve etj. Këtu është edhe shefi i personelit të arsimit dhe në aspektin juridik mund të jap sqarime më detale.

Bardhyl Sylja-kjo rregullore përcakton përgjegjësinë disiplinore dhe materiale, shkeljet disiplinore, llojet e shkeljeve dhe procedurat disiplinore si dhe organet për zhvillim të procedurës disiplinore. Bazën juridike e ka në LVL dhe në Ligjin e punës.

Në vijim të fjalës së tij z. Sylja dha edhe disa sqarime në aspektin juridik për hartim të kësaj rregulloreje.

Nuk pati debatues të tjerë përkitazi me këtë pikë, kurse kryesuesja e Kuvendit kërkon që anëtarët e Kuvendit ta aprovojnë këtë pikë të rendit të punës, me vërejtjet të cilat u dhanë nga anëtarët e Kuvendit.

Aprovohet pika 2 e rendit të punës: Propozim Rregullorja mbi përgjegjësin disiplinore dhe materiale të punonjësve në institucionet edukative- arsimore dhe aftësuese në Komunën e Gjilanit, me 33 vota të anëtarëve të Kuvendit, me vërejtjet e dhënë nga anëtarët e Kuvendit, nuk kishte kundër as abstenime.

4.2 Plani i veprimit për përmbushjen e transparencës në Komunë

Sadri Arifi- në materialet e juaja e keni një dokument i cili quhet : Plani i veprimit për përmbushjen e transparencës në Komunë. Baza juridike për propozime për këtë dokument është në nenin 58 të LVL-së, në nenin 13 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Gjilanit dhe në nenin 9 të Udhëzimit administrative 05/2013 për transparenca në komuna.

Ky plan ka për qëllim t' i ofrojë publikut qasjen e monitorimit të Komunës duke përfshirë edhe menaxhimin e financave publike, prokurimit dhe sferave të tjera të cilat janë në interes për Komunën. Projekt -plani të cilin e keni para jush i ka të përfshira disa aktivitete të cilat konkretisht duhet të ndërmerren. Një mori aktiviteteve veç janë duke u zbatuar siç është mirëmbajtja e ueb faqes së Komunës, debatet dhe takimet e tjera lidhur me zbatimin e dokumenteve dhe akteve tjera me karakter të përgjithshëm e që janë me interes për publikun etj. Me miratimin e këtij dokumenti krijohet baza e mirë ligjore për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transparencë në Komunë.

Për këtë arsyeje kërkoj nga ju që ta aprovoni këtë dokument, pastaj të fillojmë plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për transparencë në Komunë.

Nevzad Isufi- edhe unë i kam disa vërejtje të vogla e të cilat janë; pika 2.3 , duhet të përmirësohet termi “projekt –akteve” dhe jo siç është “projekt –takeve” e cila shprehje është në disa vende gabimisht. Mandej “akcesive” duhet të jetë “qasjen”. Te neni 2.6 shprehja “konsistojnë” duhet të jetë “qëndrojnë”. Neni 2.6.1 duhet “ komunikim të rregullt” dhe jo “komunikimin e rregullt”. Neni 2.6.2 – flitet për freskimin e faqes së Komunës, por nuk precizohet se çfarë freskimi, në kuptimin e dizajnit apo me çfarë freskimi. Mendoj se duhet të jetë freskimi i faqes së Komunës me të dhëna të reja. Neni 3.1 janë disa gabime teknike si :”zbatimi i dispozitave të ligjore” duhet të jetë; “zbatimi i dispozitave të ligjit”.

Neni 3.2 edhe këtu janë disa gabime logjike dhe semantike sa i përket formulimit të fjalisë dhe duhet të jetë:” caktimi i rendit të punës së KK-së” dhe jo “caktimi i pikave të veçanta...”, mandej jo “drejtuar ekzekutivit”, por “drejtuar ekzekutivit”.

Gjithashtu edhe te pika 5.3 është një paqartësi përmbajtjesore dhe duhet të jetë: “për kompensim material të numrit të stafit”. Këto ishin disa vërejtje teknike dhe gjuhësore të cilat duhet të përmirësohen.

Fehmi Sylejmani- unë mendoj se edhe pse ky është Plan veprimi ka qenë desh të futet në debat publik, por nëse unë gaboj le të më korrigjojë shefi i Shërbimit të Kuvendit, mirëpo sa e di unë ky Plan nuk ka qenë në diskutim publik.

Riad Rashti- unë në emër të grupit e shprehi qëndrimin tonë dhe ne vlerësojmë se ky Plan i veprimit në Komunë të Gjilanit është i nevojshëm dhe i domosdoshëm dhe është ligjor, prandaj është mirë që ky akt po aprovohet sot. Mirëpo ky Plan duhet të realizohet me përpikëri dhe jo të mbetet vetëm si dokument, sepse ne e dimë sa ka disa të meta dhe disa dokumente nuk po publikohen në faqen zyrtare të Komunës sikur e thash edhe më parë te rasti i Prokurimit. Mandej nuk ka transparencë të mjaftueshme, kurse në mandatin tonë Komuna e Gjilanit është vlerësuar si Komuna më e mirë për transparencë

dhe ka marrë çmim për këtë nga USAID-i Amerikan. Mirëpo edhe kjo qeverisje është mirë që të vazhdojë me këtë trend sa i përket transparencës dhe ne jemi për atë që në tërësi të zbatohet ky Plan i veprimit.

Sadri Arifi-u bë pyetje se a ka qenë ky Plan në debat publik? Nuk ka qenë, sepse ky është një Plan teknik, por në diskutim publik do të jetë rregullorja për transparencën e cila do të hartohet duke u bazuar në këtë dokument.

Sa i përket gabimeve teknike dhe gjuhësore do të përpiqemi për t' i përmirësuar dhe ta bëjmë një dokument ashtu si duhet.

Nuk pati debatues të tjerë lidhur me këtë pikë të rendit të punës, prandaj kryesuesja kërkon që të aprovohet ky Plan me vërejtjet që u dhanë nga anëtarët e Kuvendit.

Aprovohet me vërejtjet e dhëna pika 4.2 e rendit të punës: Plan i veprimit për përmbushjen e transparencës në Komunë, me 28 vota të anëtarëve të Kuvendit.

4.3 Propozim vendimi mbi qasjen e PDU: “Qendra-pjesa veriore e Qytetit, “Kodra e Dëshmorëve” dhe Nën Kodra e Dëshmorëve” në Gjiilan

Lidhur me këtë pikë të rendit të punës, kryesuesja kërkon nga drejtori i DUMM që të jep sqarime para anëtarëve të kuvendit.

Valon Shefkiu- drejtori i Drejtorisë së DUMM e sqaroi këtë projekt me anë të kino-projektorit para anëtarëve të Kuvendit i cili ishte vendosur në sallë.

Nevzad Isufi- unë deshta ta bëj një pyetje e cila është lidhur me disa vendime të cilat janë anashkaluar e të cilat kanë qenë në prioritet. Të tilla janë vendimet e Planit rregullues “Zabeli” i cili kanë qenë në prioritet, por është heq dhe është fut Fidanishtja! Ndoshta këto tejkalime bëhen për arsye se në disa lagje banojnë disa personalitete politike të nivelit qendror. Pse nuk punohet me plane sipas prioritetve, por zbatohen plane të tjera?

Avdyl Aliu- në rend të punës janë tri pika pothuajse të ngjashme dhe unë propozoj që aprovimi i këtyre tri pikave të rendit të punës të bëhet në pako, sepse janë plane për revidim dhe qëndron arsyeja për një vendim të tillë.

Në emër të grupit të LDK-së i përkrahim këto tri plane, sepse kemi premtuar se do të punojmë sipas planeve. Planet rregulluese të cilat po i debatojmë tash përcaktojnë kahet e zhvillimit të asaj pjese dhe për atë arsyeje kërkojmë që me shumë kujdes ta përzgjedhim një operator ekonomik i cili do t' i hartojë këto plane. Kërkojmë bashkëpunim nga të gjithë faktorët relevant dhe kërkojmë që të bëhet diçka e cila nuk është bërë deri më tash dhe të senzibilizohet më shumë çështja e planeve dhe të kemi sa më shumë qytetarë në mënyrë që në fund të mos kemi papajtueshmëri me njerëz që kanë prona dhe shtëpi në këto lagje si ka ndodhur deri më tash. Jemi dëshmitar të asaj se jemi ngutur mjaft dhe kemi miratuar plane, por fare nuk kemi filluar për t' i zbatuar ato plane. Për këtë arsyeje dëshiroj që të jemi shumë real në kohën pasi që t' i aprovojmë këto plane. Ne jemi për aprovim të këtyre planeve.

Shukrie Rapuca- në mandatin e kaluar është punuar shumë në hartimin e planeve rregulluese dhe në realizmin e tyre, sidomos në këto tri lagje. Mirëpo sot përsëri po bëhet revidimi i këtyre planeve në këto lagje, kurse në anën tjetër ka lagje të qyteti ku qytetarët nuk kanë qasje në rrugët kryesore dhe publike. Lagje e tillë e cila ka plan urban

prej viteve të 80 dhe e tërë kjo lojë po dyshoj se po bëhet për interesa të dikujt dhe jo për interesat e qytetarëve.

Për këtë padrejtësi qytetarët e Zabelit do të dalin në rrugë dhe do të bllokojnë institucionet, por dikur do të bëhet vonë dhe pastaj do t' i bie ndërmend për këtë lagje.

Riad Rashiti- fillimisht do t' ia bëj një pyetje drejtorit të DUMM se deri ku ka mbërri procesi i revidimit hapësinor për dy zona, njëra që ka të bëjë me Lagjen e Zabelit dhe tjetra që ka të bëjë me rrugën e Prishtinës? Për këto dy plane është thënë se janë në proces të planifikimit, mirëpo dua ta di se kur pritet të përfundojë procesi i planifikimit dhe të aprovohet në KK ?

E dyta në bazë të arsyeshmërisë së këtij vendimi përmenden shumë faktor dhe pengesa të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e planeve të mëhershme. Pyetja është se a ka ndonjë plan DUMM se si do t' i zbatojë në praktikë këto plane? A ka ndonjë plan se si do të rregullohet çështja e tokës ndërtimore, sepse ka pasur shumë mos përputhshmëri të ngastrave ndërtimore, mos përputhshmëri në mes të objekteve të regjistruara dhe të planifikuara, marrëdhëniet e pazgjidhura pronëso-ro-juridike, mungesa financiare për kompensimin e patundshmërive si dhe problemet e tjera të cilat kanë penguar realizimin e planit të vitit 2002.

Në kuadër të këtyre çështjeve që i ngrita pyetja e përgjithshme është se a ka DUMM strategji për t' i realizuar këto plane, por edhe tjerat që do t' i paraqes për aprovim?

Pyetja tjetër është për Zonën Fidanishte ku është një zonë industriale e cila është miratuar në vitin 2003, si është menduar që kjo zonë të përfshihet në këtë plan, a do të jetë zonë industriale ? Në kuadër të këtij planifikimi nuk është bërë planifikimi i udhëkryqit të fshatit Shillovë , sepse e di që vetëm në anën e majtë është planifikuar zona industriale, kurse në anën e djathtë është i ndaluar ndërtimi për çfarëdo objekti. Mirëpo ne e dimë që në kohë të fundit aty janë bërë ndërtime pa leje siç është rasti i Hip Petrollit dhe është mirë që t' ia paraqitni KK-së propozimin që edhe ajo zonë ose të shndërrohet në zonë industriale ose të merret vendim që ato objekte dhe në ato hapësira mos të lejohet ndërtimi, sepse bie në kundërshtim me planin zhvillimor komunal dhe aty është paraparë edhe ndërtimi i hekurudhës. Mirëpo aty tash ka ndërtime pa leje dhe paraqitet nevoja për ndryshim të panit zhvillimor, prandaj hapat duhet të ndërmerren me kohë.

Arben Maliqi- është mirë që këto tri pikë i propozuam për aprovim në paketë, por ne edhe më parë këto plane i kemi bërë, por vetëm në letër dhe asnjëherë nuk i kemi realizuar ashtu si duhet. Mendoj se është koha planet t' i bëjmë ashtu siç na ka hije dhe duhet t' i japim përparësi disa kërkesave dhe mundësisht që këto projekte t' i hartojnë njerëzit që i kemi në Komunën tonë dhe nuk ka nevojë të bëhemi shërbëtor të dikujt tjetër! Ne kemi njerëz profesionist dhe duhet të bashkëpunojmë me njerëz tanë dhe t' i kryejmë këto punë.

Tjetër çka është me rëndësi nuk duhet harruar se komunikimin me qytetarë ta kemi si agjendë të parë, sepse ato janë prona private të qytetarëve. Duhet bindur qytetarët se kjo çështje është interes vital për vetë qytetarët. Në çdo plan është mirë që të bëhet trasimi i rrugëve dhe nëse bëhet ky trasim, atëherë nuk do të ketë mundësi të manipulimeve, por edhe të mendohet një infrastrukturë e mirëfilltë dhe jo infrastrukturë afatshkurtër. Në fund nuk duhet harruar ambientin e pastër, nuk duhet harruar hapësirat për rekreacion dhe aktivitete sportive të cilat na mungojnë shumë. Besoj se këto projekte do të zbatohen ashtu si duhet dhe siç i ka hije.

Bajram Hasani- un më tepër po ndalem te pika 4.5 lidhur me propozim-planin e

hollësishëm të Fidanishtes, sepse e dimë se në Fidanishte është bërë një planifikim, por edhe janë bërë disa ndryshime. Unë do të ndalem pak, por nuk do t'i iki fjalës revidim, por më tepër po shkojmë në hartimin e panit të hollësishëm pasi që e dimë se revidimi është paraparë me ligj dhe mund të bëhet pas 5 viteve. Ne e dimë se kompanitë të cilat merren me këto punë janë të kushtueshme, prandaj dëshiroj për ta ditur nga drejtori se çka është ky hartimi i hollësishëm i planit ?

Fehmi Sylejmani- unë nuk jam i pajtimit që të votohen në pako këto tri pikët të rendit të punës, sepse mendoj se duhet të shqyrtohen dhe debatohen pak më shumë. Lidhur me projektin e Fidanishtes për sa e di është hera e tretë në të cilin projekt bëhen revidime. Për këtë arsyeje kërkoj nga drejtori i cili është profesionist i kësaj lëmie pse po ndodh kjo kur me sa e di unë për herë të parë ky projekt është bërë nga një kompani të cilën e udhëheq arkitekti i njohur Ilir Gjinolli. Ky projekt ka qenë mjaft i mirë, por tash me këtë revidim njeri e fiton bindjen se diçka fshihet pas kësaj. Për këtë arsyeje kërkoj që të na jep sqarime drejtori, por edhe tjetër drejtori gjatë elaborimit të ketë më shumë foto (skica) dhe më shumë detale.

Valon Shefkiu – më vjen keq që gjithërë gjërat po ngatërrohen me politikë, prandaj duhet t'i gëzohemi këtyre planeve të cilat po hyjnë në revidim dhe planeve rregulluese të tjera të cilat po hartohen. Nuk është tejkaluar lagjja e Zabelit as te Tuneli ashtu siç u tha. Këto plane janë duke u hartuar në Sektorin e Planifikimit, por në bazë të kërkesave të qytetarëve ne kemi vendos që këto plane t' i miratojmë. Te Fidanishtja është një zonë e re, një Plan rregullues dhe nuk ka të bëjë asgjë me Fidanishten që është aprovuar në Kuvend më parë, por të gjithë e dimë që në atë kohë edhe janë bërë ndërhyrje të kundërligjshme, sepse sipas ligjit vetëm pas 5 viteve mund të bëhet një revidim i planit.

Sa i përket pyetjes së z. Maliqi i cili kërkon që projektet duhet të bëhen nga njerëzit tanë, mirëpo është e drejtë e secilit të konkurrojë dhe ai i cili konkurron dhe i plotëson kriteret ai duhet të zgjidhet për hartim të një plani. Sa i përket trasimit të rrugëve, këtë hap e kemi ndërmarrë dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Gjeodezisë ka përfunduar elaborati për këtë qëllim. Këto ishin përgjigjet e mira dhe iu falënderoj

Riad Rashti- pasi që e tha drejtori se revidimi në mandatin e kaluar nuk ka qenë mënyrë ligjore, por ne kërkojmë që ta dimë se në bazë të cilave fakte po e jep këtë konstatim? Mirëpo në bazë të raportit të Auditimit dhe raportit të MPL-së nuk thuhet se ka pasur ndonjë revidim jo ligjor të cilin e përmendi drejtori. Kërkoj një përgjigje se si e ka konstatuar se ai revidim ka qenë jo ligjor?

Lutfi Haziri- unë e posedoj vendimin e Ministrisë së Ambientit dhe të Administratës Publike i cili thotë se vitin e kaluar revidimi i Planit të Fidanishtes është bërë në kundërshtim me ligjin dhe planet e miratuara. Dihet shumë qartë se kush është ndërtues në Fidanishte dhe ato janë forca dhe autoritete të mëdha politike. Unë këto dy vendime i kam dërguar në interpretim ligjor për të parë angazhimin tonë se si duhet vepruar, sepse ne jemi para aktit të kryer, aty kanë filluar disa objekte të ndërtohen.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja e Kuvendit kërkon që të aprovohen pika 4.3, 4.4. dhe 4.5

Aprovohen në pako pikat e rendit të punës: **4.3** Propozim vendimi mbi qasjen e PDU: “Qendra-pjesa veriore e Qytetit, “Kodra e Dëshmorëve” dhe nën Kodra e Dëshmorëve” në

Gjilan

4.4 Propozim Vendimi mbi qasjen e revidimit të PDU: “Zona Perëndimore-Qarku” në Gjilan dhe **4.5**-Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të PRR të hollësishëm: “Fidanishte” në Gjilan, me 22 vota të anëtarëve kuvendit, kurse 8 ishin kundër, abstenime nuk pati.

4.6 Kërkesë e DAP-it për bartjen e shpenzimeve postare të pilot projektit “HOME KOMUNA-APLIKO ONLINE”

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- për këtë çështje jemi dakorduar në KPF, kurse unë po e hapi debatin dhe nëse ka dikush për të propozuar diçka të urdhërojë?

Zijadin Maliqi- grupi kuvendar i LDK-së e përkrah këtë projekt, sepse është një projekt i mirë dhe vetë emri tregon “Komuna në shtëpi”, Apliko drejtpërsëdrejti, por në bazë të Rregullores për taksa dhe tarifa për dokumente të caktuara bëhet pagesa sipas kësaj rregulloreje. Mirëpo me këtë projekt pjesa më e madhe e mjeteve shkon për shërbime postare, prandaj ne në Kuvend duhet ta marrim një vendim që për këto shërbime të bëhet pagesa nga pjesa e buxhetit të Komunës, por për shërbimin që e bën posta ne t’i bëjmë pagesën në bazë të vendimit të KK-së.

Sahit Abazi –në emër të grupit të PDK-së ne e mbështesim këtë kërkesë, por edhe në KPF jemi pajtuar dhe e përgëzojmë drejtorin për këtë sukses që është bërë, sepse dihet botërisht se kjo ka qenë nismë e mëparshme. Gjithashtu pajtohemi edhe me z. Maliqi, sepse për shërbimet të cilat i kryen posta ne duhet t’ia bëjmë pagesën.

Selami Xhemajli- në emër të AAK-së edhe ne e përkrahim vendimin për bartjen e mjeteve për projektin “Home Komuna”. Ne këtë projekt e kemi përkrah edhe në KPF, sepse është një pilot - projekt i cili e ka arsyetuar aplikimin e tij. Në bazë të informatave që kemi është një numër i madh i qytetarëve të cilët e shfrytëzojnë këtë projekt dhe ne e përkrahim.

Nevzad Isufi- edhe ne e përkrahim këtë nismë, sepse është një zgjidhje e mirë të cilin projekt e kemi debatuar edhe në KPF, prandaj jemi për ta aprovuar këtë projekt.

Riad Rashiti- unë desha vetëm ta di se sa përafërsisht e ka koston vlera për t’i mbuluar këto shpenzime, sepse ne duhet të jemi një njohuri lidhur me shumën se sa duhet paguar shërbimet postare.

Arben Maliqi- ky është një projekt të cilit ia ka lakmi e tërë Kosova dhe është projekt që duhet përshëndetur kryetarin , drejtorin dhe në tërësi Komunën e Gjilanit. Kjo është një meritë e përbashkët, por merita më madhe është e atij i cili e ka realizuar. Mirëpo unë kërkoj një përgjegjësi më të madhe nga Administrata, sepse para disa viteve aty janë bërë gabime të mëdha, sepse për një shkronjë mund të refuzohet kërkesa e qytetarit. Duhet pasur kujdes dhe kur të lëshohet dokumenti ai duhet lëshuar pa asnjë gabim.

Arben Mehmeti- nga ajo që u fol u tha se ky projekt është një kontinuitet nga e kaluara! Mirëpo unë edhe punoj në Postë dhe jam anëtar i KK-së dhe asnjëherë nuk është debatuar për këtë projekt. Ky është një projekt në tërësi i ri dhe si model e ka marrë edhe Komuna e Prishtinës. Në vend që Gjilani ta merr model Komunën e Prishtinës, në këtë rast Prishtina e ka marrë model Komunën e Gjilanit. Ky është një projekt tejte i mirë,

projekt me të cilin iu ofrohen dokumentet qytetarëve dhe është një ndihmë shumë e madhe. Unë kërkoj nga Administrata që me këtë projekt të rritet numri i dokumenteve me të cilat qytetarët duhet të pajisen me anë të këtij projekti.

Selvete Shurdhani- edhe unë si anëtare e KPF-së dhe anëtare këtij Kuvendi e përkrahi këtë pilot-projekt, sepse për këtë projekt ka vlerësim të mirë, por edhe ka vlerësim shumë pozitiv nga qytetarët dhe është i pari i cili po realizohet në komunat e Kosovës. Në fund dëshiroj që ky projekt mos të mbetet vetëm pilot-projekt!

Nazim Gagica-i falënderoj të gjithë ata që në mënyrë unanime e përkrahën këtë projekt, por kam edhe një sqarim shtesë nga ato që nuk u përmendën. Ky projekt është një prej projekteve të parapara nga MPL dhe në kuadër të këtij projekti është platforma për shërbime për qytetarët të vitit 2011 dhe në raportin e funksionalizimit të softverit nëpër komuna në vitin 2013 del se asnjë komunë nuk e ka shqyrtuar këtë çështje. Nga kjo shihet se është Gjilani Komuna e parë e cila e ka zbatuar këtë projekt, pastaj ka vazhduar Prishtina, kurse këto ditë do të fillojë edhe Gjakova. Nga data 7.5.2014 deri më sot i kemi 412 aplikime dhe 312 dërgesa i kemi të qytetarët, kurse 68 lëndë janë në proces, kurse 30 janë të refuzuara.

Kërkesa kemi edhe jashtë komunës së Gjilanit si Ferizaj, Shtime, Prishtina dhe Podujeve, kurse edhe nga Parteshi e kemi një aplikues. Në bazë të një para llogarie që e kemi bërë, kostoja për një muaj mund të jetë diku deri në 300 €, kurse për 6 muaj kujtoj se e tërë kostoja duhet të jetë afër 2 mijë €. Kjo është kërkesa e jonë që këto mjete të barten të cilën pyetje e bërë z. Riadi. Është e vërtetë se në të kaluarën ka pasur shumë gabime, sidomos në kohën kur ka administruar UMNİK-u, por ne tash jemi duke u marrë intensivisht me përmirësime. Zgjerimin e dokumentacionit po mundohemi ta bëjmë dhe nga 9 dokumentacione në 6 kemi arrit. Ju faleminderit

Besë Baftiu— unë e kuptoj se tash jemi në kohë të fushatës, mirëpo kam një ndërhyrje tek anëtari i Kuvendit nga LDK i cili e tha se Prishtina e ka marrë model Gjilanin. Mua më vjen mirë që e paska marrë një model të mirë të cilin edhe ne e përkrahim, por do t'ia bëj një pyetje pse ju nuk e merrni modelin e Prishtinës për t'ia ndal ndërtimet pa leje?

Të gjithë e dimë se në Prishtinë të gjitha ndërtimet pa leje janë ndal, kurse në Gjilan para syve të qytetarëve nuk është ndal ndërtimi i “Hip petrolit” të cilin ndalim e kemi kërkuar në Kuvend, por e kërkojnë edhe qytetarët e Komunës së Gjilanit.

Arben Mehmeti- për rëndësinë e këtij projekti më nuk bëhet fjalës, sepse është konstatuar se është projekt me rëndësi të madhe, sepse nga Shtimja njerëzit kanë aplikua, por r dhe nga tërë Kosova nxirren dokumente në mënyrën më të lehtë të mundshme. Kjo është një risi në këtë qeverisje, sepse ky projekt e bën qytetarin që të ndihet mirë dhe ne e kemi bërë autostradën në këtë formë.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 4.6 e rendit të punës?

Aprovohet pika 4.6 e rendit të punës: Kërkesë e DAP-it për bartjen e shpenzimeve postare të pilot projektit “HOME KOMUNA-APLIKU ONLINE, me 33 vota të anëtarëve të Kuvendit, nuk kishte kundër as abstenime.

4.7. Konstituimi i Komitetit dhe themelimi i Zyrës për të Drejtat e Shqiptarëve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit.

Sadullah Kadriu –konsideroj se që nga konstituimi i këtij Kuvendi, kjo është pika më e rëndësishme e rendit të punës e cila po debatohet sot. Ka qenë një kërkesë e kahershme edhe nga pushtet e kaluara të komunave dhe ka qenë një iniciativë për ta konstituuar një komitet dhe një Zyrë për çështje të Kosovës Lindore. Mirëpo sot duhet të shqyrtohet kjo mundësi dhe të formohet një komitet dhe hapja e një zyre për qytetarët e Kosovës Lindore. Jam shumë i bindur se disa anëtarë të Kuvendit janë qytetarë të asaj treve, kurse një pjesë e mirë kanë ndonjë lidhje direkte apo indirekte me këto komuna. Këto komuna janë toka të cilat kanë mbetur jetimë, mirëpo nëse sot anëtarët e Kuvendit, sot e votojnë një kërkesë e cila ka dal nga gupet e qytetarëve dhe nga kryetari i Komunës, mendoj se e nderoni qytetin e Gjilanit, i nderoni ata qytetarë të cilët jemi në njohuri se në çfarë kushte jetojnë.

Një hapje e një zyre është një dritare e vogël për atë pjesë, qytetarët e Gjilanit do ta nderojnë edhe veten dhe qytetarë kësaj ane të cilët jetojnë në Gjilan. Kërkoj nga të gjithë që ta debatohet këtë çështje, por edhe ta votojmë në mënyrë unanime, sepse është në dobi të qytetarëve të atyre komunave dhe qytetarëve të Gjilanit.

Arben Mehmeti- ne si komision statuar jemi duke punuar në ndryshim dhe plotësim të statutit të Komunës dhe kërkesën nga ekzekutivi i Komunës dhe nga grupet e ndryshme për këtë çështje do të parashihet edhe me statut. Ne jemi në fazën ku po i presim disa propozime për ta modifikuar statutin, por ne sot duhet ta marrim një vendim që sot të del në debat publik për ta dhënë gupet e interesit mendimin e tyre. Në debate ne e presim një pëlqim për të vazhduar me këtë procedurë për krijimin e komitetit dhe formimi i një zyre për qytetarët e Kosovës Lindore.

Avdyl Aliu- në vazhden e realizmit të premtimeve dhe planifikimeve, normalisht që ne e përkrahim këtë propozim në emër të grupit të LDK-së në Gjilan.

Fehmi Sylejmani – edhe ne si grup i LVV në parim e përkrahim themelimin e këtij komiteti dhe unë nuk e shoh pengesë atë propozimin e A. Mehmetit pse duhet të shtyhet themelimi i këtij komiteti dhe të del në debat publik, kur dihet se KK ka të drejtë të themelojë komitete. Unë mendoj se sot duhet ta aprovojmë këtë pikë të rendit të punës.

Sahit Abazi – ndihem jashtëzakonisht mirë pasi që në fund po realizohet një premtim praktik i kësaj qeverisje pavarësisht se po realizohet në kohë elektorale dhe mendoj se po mos të ishin zgjedhjet ndoshta edhe më tepër do të ishte zgjatur kjo punë. Mirëpo e rëndësishme është se ky komitet po themelohet dhe qytetarët tanë të Kosovës Lindore tash e tutje e kanë një adresë dhe nëpërmes kësaj zyre do të adresohen kërkesat e tyre për të drejtat elementare të tyre.

Një kërkesë e tillë ka qenë edhe e pushtetit paraprak dhe në fund të mandatit ishte afër finalizimit dhe si grup i PDK-së e mbështesim dhe pajtohemi me propozimin Arbenit që kjo çështje të debatohet në debate publike në mënyrë që të plotësohet me ide nga qytetarët e posaçërisht të atyre nga Kosova Lindore. Në parim e mbështesim kërkesën.

Lufti Haziri- unë dua ta konfirmoj planin tonë për mbështetjen dhe implementimin e vendimit elektorale i cili implementim duhet të hyjë edhe në statut. Ne e kemi mbështet qëndrimin tonë në rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në këtë rezolutë përmendet edhe emri i sponsorit, sepse rregull parlamentare është atje. Jam i nderuar që USAID-i është për këtë dhe së bashku duhet ta rekomandojmë dhe së bashku ta jetësojmë. Po theksoj se kjo nuk lidhet me çështjen e fazës elektorale, sepse “Vatra” e

ka nënshkruar me liderin e PDK-së marrëveshjen. Ky është plan i cili shkon për rekomandim në ndryshim në statut ose eventualisht për debat. Gjithashtu mendoj se ky rekomandim do të ndikojë edhe në Fushë Kosovë që së paku edhe atje të hapet një zyrë dhe së paku një pikë e rezolutës të jetësohet, sepse e kemi për borxh dhe detyrë të ndihmohen për t' i zgjidh problemet qytetarët e kësaj pjese.

Renan Imam – edhe unë mbështes këtë propozim-vendim dhe i uroj sukses në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve të Kosovës Lindore.

Sahit Abazi- unë nuk thash asgjë tendencioze, sepse nuk është ka asgjë të keqe, sepse edhe në fushatë kryhen punë të mira dhe është mirë kur kryhen punë të mira.

Izmi Zeka- mua më duket se fjalën rekomandim duhet hequr, sepse kur të merret një vendim me 2/3 e Kuvendit e themelon komitetin në rastin konkret, kurse komisioni statutar e ka për obligim për ta inkorporuar në statut. Nëse i kalon 2/3 në Kuvend, atëherë është obligative që të inkorporohet në ndryshime statutare.

Arben Mehmeti- është pikërisht Qeveria e z. Zeka e cila i ka bërë disa rregulla dhe kërkojnë disa implementime në praktikë. Janë me Udhëzime administrative që parashikojnë çështjen e ndryshimit të statutit dhe ato ndryshime duhet të bëhen sipas procedurave ligjore, si debate publike për t' iu dhënë mundësia edhe dikujt tjetër për ta dhënë ndonjë propozim.

Imet Rrahmani- përshëndes këtë iniciativën dhe natyrisht se e përkrahi nevojën e konstituimi të një komiteti të tillë dhe pasi që jam me prejardhje nga një trevë e tillë, por nuk jam i njoftuar mirë me problemet e popullatës të shpërngulur nga këto vise? Mirëpo e dimë se një numër i madh i familjeve i kanë të paralizuar të drejtat qytetare, por nuk janë familje që vijnë vetëm nga këto tri komuna, por probleme të ngjashme kanë edhe fshatrat e Malësisë së Kumanovës. Unë po dal te ai rreziku e që unë nuk pajtohem me konstatimin mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve me prejardhje nga Kosova Lindore. Këtu janë jo rastësisht 5 anëtarë të votuar me prejardhje nga ajo pjesë dhe unë nuk i kam votat të ndara të Luginës dhe vota të tjera. Votat e mia dhe kolegët e mi që janë në parti të tjera, korrespondojnë me të gjitha lokalitetet e komunës sonë. Unë konsideroj se ndihem gjilanas si të gjithë të tjerët që janë këtu dhe që kanë lindur në Gjilan, sikurse që ndihme zarbicali, silur ngjashëm pa asnjë përqindje më të vogël sikur ato dy familje që sot mbajnë ndezur vatrës stërgjyshore në Zarbicë. Si shembull i veçantë është familja e Sinan Fejzullahut i cili ka lënë komoditetin e të jetuarit në Prishtinë dhe ka dal të jetojë në Zarbicë. Unë nuk pajtohem me ndarjet ose konstatimet që ky komitet do t' i mbrojë të drejtat e qytetarëve me prejardhje nga Kosova Lindore, por ky komitet do të merret me të drejtat e qytetarëve të cilat nuk janë realizuar ende në Komunën e Gjilanit. Unë ndihem i barabartë në mesin e të gjithëve.

Selami Xhemajli- edhe ne si grup i AAA-së e përkrahim iniciativën për konstituimin e këtij komiteti dhe zyrës, sepse kjo është kërkesë e hershme e qytetarëve të atyre viseve. Për aq sa ka kompetenca Komuna, sepse në këtë rast ka edhe kompetenca të nivelit qeveritar dhe Komuna nuk mund t' i realizoj disa kërkesa të tyre. Mirëpo komiteti dhe zyra sado pak do të ndikojë në realizmin e kërkesave të drejtave të qytetarëve që vijnë nga ato vise. Unë në emër të grupit të kuvendarëve i jap mbështetje të plotë rekomandimit për amandamentimin të statutit për konstituim të këtyre dy trupave.

Bajram Hasani- edhe unë përshëndes këtë pikë të rendit të punës për konstituimin e zyrës për Kosovën Lindore. Mirëpo unë dëshiroj ta di se cili është roli i kësaj zyre? Gjithashtu pas konstituimit është mirë që kjo zyrë të dal me disa statistika konkrete, sepse ne e dimë që një numër i madh i atyre viseve jetojnë pas luftës në Gjilan, dhe nuk kanë dokumentacion. Për këtë arsyeje duhet të hyjnë në këtë plan dhe nesër të dilet me statistika të sakta se sa banorë të këtyre viseve jetojnë në Komunën tonë dhe nuk kanë dokumentacion?

Sadullah Kadriu- gjatë debatit u shtruan disa pyetje edhe direkte dhe indirekte, por kjo e fundit më bërë përshtypje pak më shumë. Drejtori i Drejtorisë për Administratë ka konfirmuar se afër 400 persona janë paraqitur në zyrat e Komunës së Gjilanit e të cilët nuk kanë dokumentacion. Këta qytetarë që nga përfundimi i luftës jetojnë në Gjilan, por nuk posedojnë asnjë dokument. Ne kemi kërkuar që këtyre njerëzve t'iu epet nënshpëtimet. Doktor i Met për mua e pati një diskutim pak të çuditshëm dhe është e vërtetë se edhe unë ndihem gjilanas, por asnjë çast nuk e harroj vendlindjen time, por qëllimi i kësaj zyre është që të ngrisin zërin për shumëçka. Vetëm një SHKA përmes kësaj zyre nëse shkon dhe e mban një koncert në Bujanoc duhet ta dini se e ka efektin pozitiv, por edhe ndonjë shfaqje ose ndeshje sportive, sepse Serbia bën shumë gjëra, bën zyra ndërlidhëse ambasada etj, Gjilani e nderon veten më tepër se ata qytetarë të Kosovës Lindore. Kjo zyrë i bën më të vetëdijshme institucionet për të bërë më shumë për ata qytetarë.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 4.7 e rendit të punës?

Aprovohet pika 4.7 e rendit të punës: Konstituimi i Komitetit dhe themelimi i Zyrës për të Drejtat e Shqiptarëve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit, me 34 vota të anëtarëve të Kuvendit.

4.8- Vendim për shpalljen e debatit publik për ndryshime statutare

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – ky propozim -vendim doli nga tropizmi i anëtarit të Kuvendit. Z, Arben Mehmeti, prandaj të deklaroheni se kush është që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës?

Aprovohet pika 4.8 e rendit të punës: Vendim për shpalljen e debatit publik për ndryshime statutare, me 34 vota të anëtarëve të Kuvendit.

Të ndryshme

Imet Rrahmani - unë edhe më parë i kam ngrit dy çështje: e para ka të bëjë me Lagjen “Arbëria” për të cilin rast kam bërë edhe kërkesë me shkrim sipas kërkesave të qytetarëve. Kërkesa e qytetarëve është që në këtë lagje duhet të vlerësohet nga drejtoritë përkatëse funksionaliteti i parkut, sepse ka vlerësime se ai park nuk është konformë standardeve. Drejtoritë përkatëse sa më parë duhet të marrin masa për ta ndryshuar gjendjen në këtë park, me theks të veçantë që të hapen hapësira për parkingje të cilat do të shërbejnë për të gjithë ata që bëjnë rituale në xhami.

E dyta që ka të bëjë me këtë po në të njëjtin vend duhet të hapet një rrugë e cila i ka mbyllur një numër të madh të qytetarëve për lidhje direkte me rrugën kryesore dhe aty disa tregtarë me vetiniciativë po e shfrytëzojnë atë hapësirë për shitjen e produkteve

bujqësore. Është kërkesë e qytetarëve që aty të krijohet hapësira e nevojshme për një mini treg po në atë hapësirë.

Kërkesa tjetër e qytetarëve është se në bizneset private tregtare sidomos në bizneset e mëdha është që të respektohet Rregullorja komunale për orar të punës së këtyre bizneseve e sidomos në orët e mbrëmjet dhe ditëve të vikendit dhe ditëve të festave. Inspektorati i punës duhet ta monitorojë gjendjen, sepse në këto biznese ka edhe shkelje të rënda të drejtave të punëtorëve.

Nevzad Rushiti- unë i kam dy shqetësime të qytetarëve: e para është fjala për rrugën “Elez Agushi” te Der Mëhalla që nga xhamia deri te Stacioni i Autobusëve në të cilën rrugë janë krijuar vështirësi, sepse rruga është bërë me një kahe. Kërkojmë në emër të banorëve të asaj rruge që përsëri kjo rrugë të kthehet në pozicion të mëparshëm dhe të bëhet me dy kahe, sepse në anën e djathtë parkohen vetura, kurse ana e majtë mbetet shumë e ngushtë për qarkullim e sidomos emergjenca.

Kërkesa tjetër ka të bëjë me Lumin Mirusha, sepse qytetarët e kërkojnë një sqarim më konkret se si do të duket projekti final? Mundësisht që drejtoria përkatëse ose zyra përkatëse ta publikojë një pano të madhe për ta ditur se si do të duket ky projekt?

Bujar Nevzadi- përsëri po i tërheq vërejtjen kryesueses se si po sillet në raport me mua! Kërkoj që kryesuesja të jetë korrekte ashtu si kërkon statuti dhe rregullorja! E para kërkoj pra që të keni sjellje korrekte.

E dyta e kam një pyetje për drejtorin e Arsimit pse nuk po e rregullon ujin në Shkollën “Selami Hallaçi”? Në atë shkollë uji rrjedh vazhdimisht dhe në këtë mënyrë bëhen shpenzime të panevojshme! E dyta për drejtorin e Arsimit, kërkoj sqarim për nxënësin Adelina Leka e cila është nxënëse e Shkollës së Mesme të Artit Pamor e cila në fund të gjysmë vjetorit të dytë e ka lëshuar shkollën dhe fare nuk ka qenë në mësim, por me informatat që i posedoj ajo është vlerësuar (notuar)?

Pyetje e tretë për kryesuesen është Nezahate Agushi si u zgjodh anëtare e komitetit?

E katërta ka të bëjë lidhur me Shtëpinë e Kulturës për të cilin projekt kërkoj që të përfundojë pasi që mjetet janë edhe nga Ministria e Kulturës dhe nga Komuna.

E pesta rruga që e lidh Dheun e Bardhë me Shkollën “Musa Zajmi” është rrugë të cilën ne e kemi trasuar, por ka mbetur për pa u përfunduar për 20-30 metra, prandaj kërkojmë që të përfundojë ajo rrugë! Këto ishin kërkesat e mia?

Fehmi Sylejmnai- unë i kam disa pyetje e prej të cilave dy-tri lidhen me fushën e arsimit e që ndoshta edhe nuk e kanë vendin në pikën nën të ndryshme, sepse arsimit është një fushë e gjerë e cila kërkon vëmendje dhe angazhim më të madh.

E para pyetje për kryetarin është se çka po ndodh me 4 pagat e fundit për pensionistët e të cilat disa nuk i marrin! Për çfarë arsye nuk i marrin?

Pyetje e dytë objekti afër Gjimnazit i cili është duke u ndërtuar a ka leje dhe çfarë leje posedon? E treta fusha e zbrazët te shkollat e mesme e cila është shndërruar në parking për qytetarë, kurse më parë ka qenë e planifikuar të jetë një fushë e sportit. Çka po ndodh me atë fushë? Një pikë e rendit të punës për seancat e radhës duhet të jetë debat për trafikun urban?

Pyetja e radhës ka të bëjë me llap-topët, sepse më parë është përmendur kjo çështje nga Shefi i Shërbimit të Kuvendit, por tash është heshtur kjo punë? Është seanca e shtatë ne ende nuk kemi llap-topë. Një pyetje tjetër që i takon fushës së arsimit është inkuadrimi i një punëtoresje në Shkollën “Thimi Mitoko” për të cilën kërkoj ta dimë se a ka kualifikim dhe çfarë kualifikim ka ?

Në pyetje për drejtorin e Inspeksionit, është lidhur me çmimet e artikujve të qendrat e mëdha tregtare nuk janë në përputhshmëri me faturën e paguar në arkë. Do të ishte mirë që Drejtoria e Inspeksionit të merret me këtë çështje dhe ta rishikon, sepse në sirtar është një çmim tjetër, kurse në arkë bëhet pagesa me një çmim krejt tjetër!

Sahit Abazi- unë po e paraqes një shqetësim të mësimdhënësve të shkollave të mesme profesionale, sepse mbi 20 mësimdhënës e kanë shprehur dëshpërimin e tyre, sepse flitet se që nga shtatatori një numër bukur i madh i mësimdhënësve do të mbetën pa vende të punës! Pyetje është se pse vetëm në Gjilan ndodh kjo dukuri dhe kërkoj sqarim për këtë? Me sa kam informacion unë në shumicën e komunave nuk parashihet dhe nuk ka ndonjë shqetësim që mësimdhënësit të mbesin pa vende të punës! Ata këtë shqetësim nuk e kanë, sepse nuk e kanë kufizuar numrin e nxënësve në 32 për çdo paralele. Kemi mundësi që të jenë 24-22 dhe nuk është e domosdoshme që të jenë 32, sepse nëse e marrim këtë qëndrim, atëherë duhet të zvogëlohet numri i paraleleve (klasave).

Pyetje tjetër është për drejtorin e Zhvillimit Ekonomik, sepse në një prononcim ka thënë se Konferenca e Donatorëve është shtyrë për shkak të fushatës elektorale! Të na ept një sqarim nga drejtori!

Sadullah Kadriu- i kam disa kërkesa për drejtorinë e Arsimit e të cilën do ta lexoj e cila kërkesë ka të bëjë me emërtimin e disa shkollave.

Në Komunën e Gjilanit janë ndërtuar disa shkolla fillore dhe të mesme e të cilat ka një kohë bukur të gjatë dhe nuk janë emërtuar, por ndonjëherë edhe duhet t' i ndërrohet emri. Jemi dëshmitar se në shkollën në rrugën në drejtim të Prishtinës identifikohet me emrin “Shkolla të Marketi “Pireva” i cili market nuk ekziston më dhe shtrohet pyetja a kërkon koment kjo ?

Mandej ka shkolla të cilat e mbajnë ndonjë emër të periudhave të kaluara e emri i së cilës për kohën e sotme është i papranueshëm, sepse janë emra që iu kanë përshtatur kohës dhe momenteve të caktuara. Ne tash këto shkolla duhet t' i emërtojmë me emra të rinj dhe të personaliteteve që kanë një biografi të pastër kombëtare. Në këto raste kur e kremtojmë ditën e shkollës nuk kemi çka t' i themi nxënësve dhe gjeneratave të reja dhe në këtë mënyrë e gënjejmë edhe veten edhe fëmijët. Mirëpo duke pasur parasysh se atdhetarët dhe njerëzit me begrand patriotik asnjëherë nuk i kanë shikuar kufijtë administrativ që na i kanë imponuar të tjerët, propozoj që ndonjë shkollë e Komunës së Gjilanit të emërtohet me një figurë të spikatur që ka prejardhje nga Kosova Lindore.

E them këtë, sepse tash një numër qytetarëve të këtyre viseve jetojnë në Komunën tonë dhe kanë prejardhje nga këto troje. Konsideroj se Gjilani duke i nderuar personalitet kombëtare të cilat nuk kanë lindur këtu, por kanë vepruar në aspektin kombëtar, e nderon veten dhe jep mesazh për ata që bëjnë përpjekje për t' i ndarë personalitet e shquara. Me këtë propozim ne e nderojmë qytetin e Gjilanit dhe nderojmë veten!

Selvete Shurdhani- unë po e theksoj problemin e ujësjellësi në lagjen e vjetër të qytetit “7 Korriku”, sepse problemet e ujësjellësit në këtë lagje janë shumë të mëdha për shkak të vjetërsisë së gypave të ujësjellësit e të cilët rrjedhin gati në çdo dy ditë! Këto ditë ka pasur një defekt ditën e premte, kurse sanimi është bërë të hënën dhe gjatë vikendit banorët e asaj lagjeje nuk kanë pasur ujë. Kërkoj që sa më parë që të përshejtohet ky projekt, sepse tash po hyjmë në stinën e verës, temperaturat janë më të larta dhe problemet për ujë mund të jenë me pasoja shumë të mëdha. Është nevojshme që ky projekt sa më parë të përfundojë!

Arben Maliqi- unë kam diçka tjetër, sepse jemi në prag të zgjedhjeve qendrore dhe sot presim hapjen e fushatës dhe e kam një apel për të gjithë qytetarët e degëve dhe për ne kuvendarët që të reflektojmë pozitivisht tek anëtarët tanë, aderuesit dhe te popullata e Anamoravës, respektivisht Gjilanit. Dihet shumë mirë se Gjilani gjithmonë ka treguar një frymë demokratike, një tolerancë, mirëkuptim dhe respektim të ligjit, prandaj edhe kësaj radhe gjatë tërë fushatës të reflektojmë pozitivisht. Gjithashtu ata kandidatë të cilët janë dominuar për deputet t' i votojmë më të mirët dhe mos të bëhemi argat të tjetër kujt dhe mos t' i harrojmë njerëzit tanë pa dallim partie.

Fatbardhë Selmani- unë sa ishte kryetari këtu i bëra tri pyetje, kurse njëren prej tyre e kam bërë edhe me shkrim. E kam marrë një përgjigje për pyetjen të cilën e kam bërë me shkrim, kurse nuk mora përgjigje për dy të tjerat! E para pyetje është cili është ia person i ci dëshiron të degradohet nga pozita siç është rasti me drejtorin e QKMF-së. Kryetari i Komunës e tha se kemi bërë një marrëveshje me drejtorin e QKMF-së, por në vendim është thënë dhe shkruar diçka tjetër dhe nuk ka asnjë marrëveshje ashtu siç e thotë kryetari. Në vazhdimësi drejtorit iu është bërë presion nga ana e qeverisjes së tashme duke ia marrë veturën zyrtare, mandej duke ia ndërprerë kontratën e cila ka qenë në mes CARITSASUT dhe kryetarit të Komunës të nënshkruar për 16 punëtorë shëndetësor e cila gjë e ka penguar në vazhdimësi efikasitetin e punës në shëndetësi. Mirëpo sa kam njohuri përsëri do të nënshkruhet në mes të Zyrës së Kryetarit dhe CARITASIT- Italian. Po ashtu nuk iu është dhënë asnjëherë përgjigje për disa kërkesa që i ka pasur drejtori dhe kjo dëshmon që është krijuar një obstrukcion në mes drejtorit dhe pushtetit të tashëm. Këtë e bërë vetëm për sqarim pasi që kryetari i Komunës nuk është prezent.

Riad Rashiti – unë në fillim të seancës i ngrita dy kërkesa e të cilat kanë të bëjnë me pikën nën të ndryshme. Një e kam drejtuar edhe me shkrim për drejtorin për Zhvillim Ekonomik e cila ka të bëjë me zbatim e projektit të Mirushës. Kërkojmë që në seancën e radhës me shkrim të na sillen sa më shumë informacione se deri ku është arrit me punë lidhur me këtë projekt. E dyta ka të bëjë e një shqetësim të cilin e kemi ngritur sa i përket një shkelje ligjore për zbatimin e një projekti në hapësirat e varrezave të qytetit të Gjilanit. Ne veç i kemi edhe dëshmitë që e vërtetojnë se është një marrëveshje që është bërë me një kompani private me të cilën pasi ka përfunduar projekti është nënshkruar kontrata, dëshmi të cilat i posedojmë me fakte. Kërkoj një përgjigje nga menaxheri i Prokurimit në seancë ose nga zyrtari për projekte. Ne për 7 vite nuk kemi pasur asnjë rast që projektet dhe punët janë kryer jashtë procedurave ligjore, kurse kjo qeverisje pas tre muajve ka filluar të kryejë punë pa procedura ligjore! Mandej unë edhe në seancën e kaluar kam bërë pyetje, por kryetari nuk është përgjigj, prandaj prapë po pyes pse e ka shkarkuar komisionin komunal të ankesave?

Kryetari nuk ka dhënë përgjigje, por ne kemi informacion se ky komision është emëruar nga kryetari i Komunës në janar të këtij viti për mandat dy vjeçar, por është shkarkuar nga kryetari i Komunës, sepse ky komision profesional të cilin e ka emëruar vet kryetari i Komunës, ka bërë vlerësimin e tij profesional se punëtorët të cilët janë larguar nga vendi i punës shërbyes civil të cilët kanë punuar për shumë vite, kurse në mandatin e fundit kanë pasur pozita politike në KK, siç është rasti i anëtares së Kuvendit, Xhyzide Ismaili, e cila ka punuar në Administratë dhe nuk është kthyer në punë edhe pse me ligj të shërbyesve civil dhe me vendim të KK iu është ruajtur vendi i punës, vendim të cilin e ka përkrahur edhe LDK dhe është votuar unanimitisht. Kemi zyrtarin financiar i cili nuk është kthyer në vendin e punës, është Bahrie Mahmuti, zyrtare në DUMM, mandej Veton Nevzadi, Gani Neziri etj.

Ne si qeverisje më 2008 asnjë punëtor politik, nuk e kemi larguar nga vendi i punës dhe të gjithëve iu kemi bërë zgjidhje, as punëtorëve tjerë siç është rasti me Agim Salihun, Fitnete Mjakut etj. Kërkojmë që këto veprime të ndalen dhe këta zyrtarë të kthehen në vendin e punës! Në fund largimi i menaxherit të Zyrës së Projekteve Fadil Osmani dhe largimi i menaxherit të Zyrës së Prokurimit Hamdi Ismaili dhe kjo shkelje ligjore që ka ndodhur lidhet me atë se qëllimi shkarkimit të tyre ka ndodhur për shkak të keqpërdorimeve të cilat po ndodhin me dijen e plotë të qeverisjes komunale.

Isa Agushi – unë e kam një pyetje për kryetarin dhe Këshillin e Drejtorëve ; a i keni dhënë tenderë kompanive jashtë Komunës së Gjilanit dhe sa i keni dhënë dhe sa janë në plan për t i dhënë? Nëse keni dhënë, atëherë unë nuk pajtohem me këtë, sepse gjatë fushatës motoja e jonë ka qenë se tenderë jashtë Komunës së Gjilanit nuk do të ketë. E kërkoj një përgjigje për këtë pyetje?

Mevludë Zejnullahu- unë sërish po e shpreh një shqetësim lidhur me mësimdhënësit në shkolla profesionale, sepse paralelisht në ato shkolla po ndodhin dy reforma. Reforma e parë që po ndodh është shuarja e klasave të trembëdhjeta e cila reformë i le të papunë një numër të madh të mësimdhënëseve. Mirëpo te reforma e dytë, ndoshta kishim pasur mundësi të mos e zvogëlojmë numrin e nxënësve në klasë të dhjeta. Nëpër shkollat profesionale klasat e dhjeta po zvogëlohen në numër të madh. Vetëm në Shkollën Ekonomike përpara kanë qenë 12 paralele, kurse tash formohen vetëm 8 paralele dhe katër paralele nxjerrin një numër të madhe të nxënësve në rrugë. Kërkoj nga DKA që të ketë kujdes dhe të mos ndodhin të dy reformat për një vit?

Arben Mehmeti- unë e kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, sepse ky Kuvend e ka marrë një vendim për parkingjet publike, prandaj është udhës për ta ditë ne si Kuvend se deri ku ka shkuar ky proces? Me sa e di unë parkingjet ende janë duke u menaxhuar nga kompanitë private, prandaj është e udhës që këto parkingje të menaxhohen sipas rekomandimit të Kuvendit. Gjithashtu duhet të bëhet edhe një raport financiar se si janë menaxhuar ato parkingje, sa mjete janë grumbulluar dhe ku janë shpenzuar ato mjete? Këtë informacion drejtori i Shërbimeve Publike duhet ta sjell më së largu në seancën e radhës.

Mandëj në lagjen Dardania afër Postës së vogël janë të rrezikuar shumë fëmija, nxënësit për shkak të parkingjeve ilegale, sepse në ato parkingje veturat parkohen pa asnjë rregull. Problem tjetër është edhe rruga që shkon në drejtim të Kolegjit “Fama”, sepse edhe aty parkohen veturat pa asnjë rregull, por e njëjta gjendje është edhe te Shkolla “Selami Hallaçi” dhe aty është një anarki e plotë e cila dukuri nuk është sinjal i mirë për Komunën.

Sadullah Kadriu – unë do ta ngris një shqetësim i cili në seancën e kaluar është aprovuar në Kuvend dhe kjo ka të bëjë me Komisionin për zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave, Vendbanimeve dhe të Lagjeve dhe Komisioni për ndarjen e bursave e që në procesverbal, kryesuesja Valentina thotë:” përcaktimi bëhet nga subjektet politike sipas fuqisë që ekziston në Asamblenë Komunale dhe sa i përket pyetjes së z. Hajdini, ata që e kanë një ulëse në këtë Kuvend duhet të merren vesh dhe të na e sjellin një emër”. Mirëpo ne as që jemi ftuar nga kryesuesja dhe me gjasa janë konstituuar ato komisione, por ne nuk jemi askund dhe nuk është bërë përfaqësim i të gjithë atyre që janë pjesë e Kuvendit.

Jehonë Hyseni – unë pasi që jam anëtare e Komitetit për Zhvillim Ekonomik desha të sqaroj atë u tha se gjëja se Konferenca e Donatorëve është shtyrë për arsyeje të fushatës. Unë nuk e di se dikush e ka thënë se kjo konferencë është shtyrë për këtë arsyeje? Unë asnjëherë nuk e kam thënë se kjo konferencë është shtyrë për shkak të fushatës, por nëse dikush e di ndonjë emër që ka dhënë një deklaratë të tillë, atëherë është mirë që ta dimë dhe ne!

Selver Xhelili- unë në pozitën e drejtorit të Inspeksionit e kam për obligim që të jap përgjigje në pyetje të z. Nevzadit për ndërtimet në Komunën tonë. Së pari unë si drejtor i kësaj drejtorie jam duke i kryer të gjitha obligimet në pajtim me të gjitha dispozitat ligjore të cilat më takojnë. Aktualisht sa i përket ndërtimeve mbi 80% janë të pajisura me dokumentacion, kurse një numër i vogël i objekteve kanë hyrë në procedura, prandaj ne si Inspeksion nuk e kemi qëllimin vetëm të rrënojmë objekte dhe t' i bëjmë dëme qytetarëve, por kemi për qëllim për ta vetëdijesuar qytetarin që të ketë dokumentacion gjegjësisht leje ndërtimi. Në Drejtorinë e Inspeksionit lista është publike dhe i ftoj të gjithë të interesuarit që t' i marrin informatat bazë dhe unë do të jem dorë e zgjatur e qytetarëve për ta krijuar një jetesë sa më të mirë që qytetarëve tanë. Mirëpo ne nuk kemi edhe kushte për vepruar ashtu si duhet, sepse ende nuk e kemi kompaninë e rrënimit, por e cila është në procedura të tenderimit. Lidhur me pyetjen e z. Sylejmani lidhur me dallimet e çmimeve, ka pasur kontrollime dhe ka pasur edhe gjoba për këtë dukuri, por unë si drejtor e marrë për obligim që të rris efikasitetin në këtë aspekt dhe ta eliminoj këtë dukuri.

Sahit Abazi- ajo e cila më shqetëson në përgjigjen e drejtorit është një argument se nuk paska kompani të rrënimit. Në këtë rast përgjegjësia është te Zyra e Prokurimit, sepse nëse nuk ka kompani të rrënimit dhe Zyra e Prokurimit nuk e ka proceduar së pari ka dyshime të mëdha për këtë dhe e dyta ka shqetësime dhe e treta nganjëherë po krijohet bindje që Inspeksioni nuk po punon, kurse faji po del diku tjetër. Për mua është shqetësuese kjo përgjigje!

Bujar Nevzadi – nga ajo që e tha drejtori po e konstatojmë se vetë Qeveria Komunale vetë drejtori të dihet publikisht se këtu nuk funksionon Qeveria Komunale dhe ndërtimet janë duke u bërë pa leje për arsye se drejtori e tha se nuk kemi kompani të rrënimit. Të dihet publikisht dhe atë vetë po e pranon se nuk është duke funksionuar Qeveria Komunale.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- në sqarim dua ta jap. Replika zgjat dy minuta, mandej vjen sqarimi i drejtorit dhe përfundon debati rreth një çështje, të kuptohet.

Selver Xhelili- unë e thash se kompania është në tenderim dhe jemi duke i zbatuar procedurat ligjore në Zyrën e Prokurimit dhe besoj se të gjitha objektet të cilat janë në listë do të merren masa kur të kemi kompani të rrënimit. Unë po e sqaroj se kompania për rrënim të objekteve është në tenderim.

Sali Kçiku- unë i pata dy pyetje nga anëtarët e Kuvendit; e para për pagesën e bursave të studentëve, por ju e dini se ato janë pagesa nga viti i kaluar të cilat kanë mbetur, por ne këtë javë e kemi bërë alokimin e mjeteve dhe është bërë zotimi për të gjitha obligimet e pakryera në vlerë prej mbi 14 mijë €. Besojmë se brenda javës të gjithë studentët do t' i kenë ato mjete në xhirollogarinë e tyre.

Pyetja tjetër ishte pse nuk është bërë pagesa e pensioneve? Këtë pyetje nuk e kam të qartë se për çka është fjala, por kërkoj ndonjë sqarim më detal ose kjo pyetje të më bëhet

në mënyrë elektronike dhe unë do të përgjigjem në atë mënyrë.

Fehmi Sylejmnai – pyetjen e për z. Kçiku e bëra unë dhe po e sqaroj se është fjala për pensionistët nga lëmia e arsimit, të cilën fakt e dinë edhe drejtori i Arsimit, por më së miri e dinë kryetari i Komunës. Ata kanë pasur takim edhe me kryetarin e Komunës, por unë dot ‘ i drejtohem edhe me shkrim drejtorit të Financave.

Nazmi Musa –mora disa pyetje dhe do të përgjigjem sa më shkurtër. Ishte një pyetje nga z. Nevzadi përkitazi me ujin në Shkollën “Selami Hallaçi”? Mirëpo ditën që e kam marrë detyrën ekziston ky problem. Kam biseduar me drejtorin dhe mirëmbajtësin dhe e kam përcjell në Zyrën e Prokurimit. Kjo është një pengesë e parë, sepse Zyra e Prokurimit duhet të jetë më efikase se kujt po ia jep tenderët për mirëmbajtje të infrastrukturës nëpër shkolla.

E dyta Adelina Leka, qenka vlerësuar (notuar), pa prezencën e saj! Mirëpo të gjithë e dinë se aty ka struktura që nga drejtori dhe kujdestari i klasës. Kujdestari i klasës e ka ditarin dhe në fund të vitit bëhet analiza e suksesit nga organet e shkollës dhe strukturat e shkollës, kurse unë nuk kam bërë asnjë informim dhe asnjë kërkesë për këtë rast.

Në çastin që do të kem ndonjë kërkesë, janë inspektorët dhe do të konstatohet se a është vërtetë apo jo që po thuhet se ka ndodhur?

Sa i përket shqetësimit për reformën e re, po e theksoj se kjo nuk është vetëm për neve, por kjo ndodh në tërë Kosovën, por i kemi edhe disa probleme të cilat i kanë paraprirë kësaj reforme e që e bënë edhe më të tendosur këtë gjendje, por këtë temë do ta lë si pikë të rendit të punës në një mbledhje të ardhshme. Këtë po e them se çështja e arsimit nuk është temë e cila mund të bisedohet në kuadër të një pike të rendit të punës me pak fjalë, por duhet të debatohet gjerë e gjerë dhe të analizohet mirë kjo gjendje.

Për çështje të emërimit të shkollave, dihet që janë 5 shkolla të cilat nuk janë të emërtuara dhe kjo ka ndodhur edhe në qeverisjen e mëparshme, por janë dhënë propozimet, mirëpo për shumë arsyeje nuk janë emërtuar. Çështja e emërimit të shkollave nuk është çështje e Kuvendit, por është e këshillit të shkollës, drejtorisë dhe ministrisë dhe absolutisht përjashtohet Kuvendi për të bërë debat këtu. Ne kemi emra të shkollave që nga Rilindja Kombëtare, nga koha e Gjon Buzukut, Pjetër Bogdanit dhe nga të gjitha trojet shqiptare, prandaj nuk ka lokalizëm pse kjo trevë është dhe tjetra nuk është? Jam për atë që shkollat të emërohen me emra nderi të patriotëve, shkencëtarëve etj. Sa i përket pyetjes së profesores Mevlyde ne do ta bisedojmë këtë çështje, sepse kemi ligje, kemi forma se si duhet punuar dhe ne nuk mund të bëjmë ligjet, por ne vetëm duhet t’i zbatojmë. Për këto gjëra në ndonjë seancë tjetër dhe do të jem në gjendje për të dhënë shpjegime edhe më detale.

Avdyl Aliu- lidhur me ndërtimet pa leje, kolegët nga opozita me këmbëngulje po kërkojnë që të konstatohet se Komuna nuk paska operator për rrënimin e objekteve pa leje! Edhe unë po deklaroj se mund të mos ketë, ose çështja është në proces, mirëpo duhet bërë një krahasim. Për 4 muaj të këtij viti janë të evidentuara 27 ndërtime pa leje e të cilat janë në proces e sipër dhe për të cilat nuk ka përfunduar procedura. Për 4 muaj i qeverisjes tjetër të qeverisjes së kolegëve, janë 170 ndërtime pa leje ! Atëherë nëse ajo “qeveri e mirë “ paska punuar mirë, paska pasur operator për rrënim le të thuhet ku janë këto rezultate dhe çka është bërë? Të dihet 170 me 27. Këto 170 thuhet në popull “kanë pi ujë”, kurse 27 janë në proces e sipër. Rasti tjetër është i komisioni për dhënie në shfrytëzim për parkingjet. Ne si KK i kemi miratuar disa komisione në parim dhe ka disa muaj që i kemi kërkuar emrat sipas çelësit politikë dhe të gjitha grupimet edhe shoqëria

civile i ka dhënë propozimet, kurse kolegët nga PDK kanë kaluar disa muaj dhe nuk i kanë sjell emrat? Ne kemi bërë shumë herë ftesë për t' i plotësuar komisionet, por nuk ka përgjigje dhe për këtë arsyeje ne jemi të bllokuar.

Bujar Nevzadi- kjo flet për këtë nivelin që po flas unë tërë kohën. Shefi i grupit kuvendar të LDK-së duhet ta dijë se u tha se po shkojmë me radhë sipas drejtorive dhe sipas pyetjeve. Ne filluam me arsim, kurse po bisedojmë për ndërtim e të cilën temë e përfunduam, prandaj nuk e di se çka i thonë kësaj?

Unë e falënderoj drejtorin e Arsimit për këto informata të shkurtra dhe shumë mirë e di problemin e tij dhe po të përpiqemi të gjithë për t' i ndihmuar është pak dhe në asnjë mënyrë mos ta bëjmë të kundërtën. Unë vetëm te çështja e ujit në "S. Hallaç" e di që është një procedurë që shkon ngadalë, por 6 muaj për ta ndërprerë ujin janë shpenzuar nga 700 euro në muaj, kurse për 6 muaj bëjnë 4200 €. Mendoj se ka pasur ndonjë mundësi tjetër për ta zgjidh këtë problem dhe të ndërpriten ato shpenzime.

Sa i përket ndërtimeve dikush nuk duhet të flet, sepse ne i dimë ndërtime e z,Avdyli ka mbi ndërtime!

Sahit Abazi- drejtori i Arsimit e tha me të drejtë që çështja e arsimit të debatohet në një seancë të veçantë, prandaj edhe ne pajtohemi dhe kërkojmë që brenda dy jave të thirret në seancë e veçantë ku dot ë bisedohet për temat e arsimit, sepse ka shumë shqetësime nga mësimdhënësit sepse që nga shtatori mund të mbesin pa punë. Ky është një propozim i yni e të cilin duhet ta keni në agjendë.

Fehmi Sylejmani- pyetjet të cilat ia drejtova drejtorit të Arsimit nuk i mora përgjigjet? Unë pyeta për fushën e sportit te shkollat e mesme e cila është shndërruar në parking dhe po e shëmton atë pjesë! Pyetja e dytë ishte punësimi i një edukatoreje në "Thimi Mitko", pyeta çfarë kualifikimi ka ajo punëtoreje. Mirëpo unë edhe po ia bëj me dije drejtorit se formula për vetëfinancimin e shkollës ekziston me sa e di unë në Gjilan dhe për punë sekondare nuk ka nevojë asnjë drejtorë i shkollës të shpall tender dhe të pres për ta eliminuar një defekt të vogël. Shkollat e kanë një fond dhe ai varet nga numri i nxënësve nëpër shkolla., por edhe numri i klasave.

Nevzad Isufi- unë i kam bërë dy pyetje dhe për të dyja mora përgjigje! Në radhë të parë e falënderoj drejtorin për Financa i cili dha përgjigje dhe ky ishte një lajmë i mirë që bursat e studentëve qenkan në ekzekutim. Mirëpo me pjesën tjetër nuk kam qenë i kënaqur, por as tash nuk jam i kënaqur, sepse nuk ishte përgjigja adekuate. Në seancën e kaluar drejtori e ka thënë se janë dy vendime të cilat presin ekzekutimin, mirëpo unë nuk e di që ka ndonjë instancë tjetër pos inspeksionit që të vazhdojë pjesën tjetër që e kalon inspeksionin? Nuk e di se a është i qëndrueshëm pohimi i drejtorit i cili thotë që në momentin e gjetjes së tenderuesit do të ekzekutohen vendimet e nxjerra për prishjen e objektit të kompanisë "Hip Petrol"i cili është ndërtuar pa leje. Më thoni se cili qytetarë e ka ndërtuar shtëpinë veresi, e ka ndërtuar dhe pastaj e ka marrë planin, lejen dhe pastaj e ka ekzekutuar objektin. Nëse drejtorit ia ka pamundësuar dikush për t' i ekzekutuar këto vendime le ta thotë dhe mos të thuhet se Ministria e Ambientit paska përgjegjësi! Ministria e Ambientit ka përgjegjësi për të dhënë leje për çështje tjera, por jo për të dhënë leje për ndërtime brenda Komunës. Unë do t' i rikujtoj drejtorit se kur të zgjidhet kompania për rrënim të objekteve që duhet ta bëjë ekzekutimin e vendimeve të cilat vet i ka marrë.

Arben Malqi- është për t' i habitur, sepse po dalim prej temës në temë, sepse kemi një përvojë kuvendare. Kur të flasim për arsim, mos të kalojmë në çështjen e ndërtimeve pa leje ! Problemin të cilin e ngriti kolegja për shkolla pajtohem, sepse aty është një problem i madh. Problemi është te klasat e trembëdhjeta dhe te punësimi, por ne morëm qëndrim që të kemi një seancë të veçantë, por duhet të përgatitemi shumë seriozisht.

Jam në njohuri se sa i përket buxhetit për këtë vit, një vit mësimdhënësit do të kenë pagë, mirëpo shtrohet pyetja se çka do të ndodh në vitin tjetër? Këtë problem duhet ta marrim shumë, shumë seriozisht këtu nuk ka dallime dhe nuk ka parti. Është mirë që një pikë e rendit të punës në seancën e ardhshme të jetë për arsimin për t' i shqyrtuar disa probleme në sferën e arsimit.

Nazmi Musa- me vetë faktin se shumica e anëtarëve të Kuvendit ishin të pajtimit që ta kemi në rend të punës debatin për arsimin shihet se sa ka probleme arsimit.

Sa i përket pyetjes së Fehmiut, fusha aktuale e zbrazët e cila ka qenë e projektuar për një fushë sportive të Shkollës "M. Barleti" e cila ka mbetur fatkeqësisht vetëm si parking, është menduar si projekt i cili ka ekzistuar dhe është në zbatim të fillimit të rrethimit të shkollave dhe stabilizimit të asaj hapësire. Ai është një plan detal dhe mendoj se së shpejti do të fillojë zbatimi i atij projekti. Lidhur me këtë fushë i kam pasur dy kërkesa dhe njëra ka qenë për të vendosur aty një lojë për fëmijë dhe vetë pronari i cili po e ndërton shtëpinë ka kërkuar që ta bëjë një parking për nevojat e tij, por që të dy kërkesat i kam refuzuar.

Sa i përket lejes së ndërtimit të shtëpisë e cila por ndërtohet aty, unë nuk e kam të drejtën për të ndërhyrë, sepse ajo është çështje e pronës private dhe ajo është çështje e inspeksionit.

Për shqetësimet e mësimdhënësve nuk epet përgjigje për pesë minuta, sepse kjo është temë më e thellë dhe duhet biseduar më gjatë. E dinë z. Bujari, por shumica nuk e dinë pse është Komuna e Gjilanit që ka probleme. Unë nuk kam dijeni se ekzistojnë pagesa për këta mësimdhënës të cilët do të mbesin pa punë. Nëse ka do të ishte më mirë t' i paguajmë këto 117 mijë € që ia kemi borxh mësimdhënësve dhe askush nuk po e shtron pyetjen pse 117 mijë € janë borxh për vitin 2012/2013. Pse 32 mësimdhënës nuk janë në listë të pagave dhe punojnë? Pse është kjo tepriçë e mësimdhënësve, pse punon një mësues me një ose dy nxënës etj? Duhet ta bëni një analizë të paktën dhe përgatituni secili për mbledhjen e ardhshme që do të debatohet si temë e veçantë!

Riad Rashiti- unë e kam një pyetje për drejtorin se a është duke i parë uzurpimet që po ndodhin brenda hapësirës së Gjilanit duke filluar nga lokalet afariste e që e kemi rastin e freskët. Pyetja është a jeni të njohur me këtë uzurpim dhe a keni marrë masa dhe çfarë masash keni marrë?

E dyta lidhur me ndërtimet pa leje të cilën çështje e ngriti Avdyli, unë pajtohem me qëndrimin e tij, por kur flet për shifra, unë nuk e di se kur i ka nxjerr këto shifra ? Mirëpo është mirë që ai që ka bërë një shkelje të tillë të mos kritikojë! Është vetë biznesi i Avdylit për të cilin në qeverisjen e kaluar është konstatuar se ka tejkalim! Z. Avdyli në secilin kat ka tejkalim, prandaj duhet të jetë i përmbajtur dhe të mos kritikojë aty ku është vetë. E që në qeverisjen e kaluar kryetari i Komunës e ka bërë maksimumin për t' i ndal ndërtimet pa leje në Komunën e Gjilanit. Disa herë kryetari ka kërkuar raport me shkrim nga inspektorët e ndërtimit dhe i ka dërguar në Komision disiplinor inspektorët Komunal për mos respektim të detyrave të punës në terren. Ndërsa qeverisja e tashme jo që nuk e bën këtë, por shkon dhe i emëron në pozita udhëheqëse zyrtarët lëndët e të cilëve nuk janë shqyrtuar nga Komisioni disiplinor dhe në bazë të informacionit tonë ky komision është shkarkuar nga kryetari i Komunës për të vetëm arsyeje për të mos i dhënë

përgjigje në lëndë të cilat kanë qenë të proceduara nga qeverisja e kaluar. Dallimi është shumë i madh si dukuri për shifra nuk po flas.

Avdyl Aliu- sa për informim po theksoj se dy objektet e ndërtuara nga kompania ime janë me leje ndërtimore, tejkalime nuk ka në gabarit as në objekt dhe janë në suaza të lejes ndërtimore e cila gjë dot ë vërtetohet dhe do të shihet. Është një tejkalim në nën kulme, por tash është ligji për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimore dhe me tejkalime. Është ky ligj në fuqi dhe të dy këto objekte dhe të gjithë të tjerat do t' i nënshtrohen trajtimit të atij ligji.

U tha se Komuna nuk paska kompani për rrënim të objekteve, por po e pyes opozitën se a kanë pasur kompani për rrënim të objekteve? Pse nuk keni bërë rrëime të objekteve pa leje? Ato do t' i merr ligji për trajtim i cili ligji vlen për tërë Kosovën dhe e ka periudhën për sa kohë duhet t' i trajtojë.

Riad Rashiti- mirë që e pranoi z. Avdyli që ka tejkalim dhe nuk është me rëndësi se ai tejkalim a është në nën kulm, apo podrum, por kryesore tejkalim ka! Mandej po them Avdylit se ne si qeverisje komunale kemi bërë rrëime edhe para fushatës zgjedhore dhe po ia tregoj në fakt dhe këtë mund ta konfirmoj ish drejtori Inspeksionit dhe rrëimi i fundit është bërë në Malishevë. Edhe pse nuk ka pasur kompani të kontraktuar, ne në Zyrën e Prokurimit i kemi shpejtuar procedurat e kemi bërë kontratën me kompaninë përkatëse e cila e ka bërë rrëimin, prandaj edhe ju mund ta gjeni kompaninë nëse jeni të interesuar brenda një afati të shkurtë.

Selver Xhelili- së pari tek objekti i "Hip petrolit" unë së bashku me këshilltarin komunal i kam ofruar edhe dokumentet se Drejtoria e Inspeksionit e ka kryer të procedurën ligjore e cila më takon mua si drejtor dhe askush nuk mund të ma mohoj për të vepruar, atëherë kur do t' i kem kushtet. Ne i kemi dhënë një afat derisa ta marrim një pëlqim nga Ministria e Ambientit dhe ata për pak ditë do ta sjellin dhe pastaj do të kalojë problemi në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit.

Pyetja tjetër ishte për objektin të shkollat e mesme, unë si drejtor së bashku me inspektorët e kemi kontrolluar këtë objekt dhe ky objekt e ka lejen e ndërtimit të cilën e ka lëshuar Drejtoria e Urbanizmit. Sa i përket rrëimeve nuk ka asnjë dokument zyrtar që është bërë ndonjë rrënim. Ndërsa sa i përket uzurpimeve ne së bashku me drejtorin e Kadastrës i kemi bërë disa incizime dhe është konstatuar se ka uzurpime, por uzurpime ka edhe nga vetë anëtarët e Kuvendit emrat e të cilëve janë të njohur për publikun. Unë nuk jam drejtor i një partie, por jam i pozitës dhe opozitës dhe jam i gatshëm në çdo kohë për t' i ndihmuar qytetarët.

Riad Rashiti- unë nuk do të përgjigjem, por e lus shumë ish drejtorin e Inspeksionit se a ka pasur rrënim sipas procedurave ligjore?

Ismet Hajdini- së pari po theksoj se gjatë katër viteve të kaluara ka pasur shumë rrëime për të cilat rrëime ekzistojnë dokumentacionet, por ka pasur edhe një numër të madh të kallëzimeve penale. Kohë pas kohe kemi pasur kompani të rrëimeve, por një kohë të gjatë nuk kemi pasur. Sa i përket objektit në fjalë(në Malishevë) ka qenë në procedurë, është e vërtetë është nënshkruar dhe është rrënuar të cilin fakt mund ta vërtetojë edhe shefi i ndërtimit i cili është këtu i pranishëm. Shifra prej 187 objekteve pa leje në vitin 2013 për herë të parë po e dëgjoj, sepse e kam dokumentacionin, por për një shifër të tillë nuk kam njohuri.

Selver Xhelili-unë nuk dua të lëshohem në statistika të vitit të kaluar, por po theksoj se në sektorin e ndërtimit janë 170 procese për ndërprerje të punës, ka objekte pa leje që janë në procedurë gjyqësore dhe presim që ato vendime të vijnë për rrënim ose procedurë tjetër. Sipas informatave që i kemi në sektorin e ndërtimit ose sipas juristit që e kemi në kuadër të drejtorisë sonë këto janë të dhënat.

Valon Shefkiu- unë po i përgjigjem z. Fehmi Sylejmanit për objektin të shkollat e mesme. Objekti ka leje të rregullt dhe ka leje të ndërtimit, sepse i ka kryer të gjitha procedurat dhe iu është dhënë leje. Sa i përket pyetjes së Riadit lidhur me komisionin është vërtetë se kryetari e ka iniciuar atë komision, por kur i ka parë dokumentet në zyrë e ka mbyllur edhe ai gojën dhe nuk ka desh të bisedojë më tutje. I kemi vizituar të gjitha objektet edhe atë të “Agro hermesit” dhe nuk ka asnjë tejkallim në gabarit dhe e them me plotë përgjegjësi. Ne i kemi shqyrtuar edhe objektet e tjera dhe ka tejkallime dhe nuk është i vetmi dhe konsideroj se është turp për ta përmendur një rrënim në Malishevë duke pasur parasysh numrin e madh të objekteve që janë bërë në Gjilan.

Riad Rashiti- nuk qëndron ajo që e tha drejtori dhe e dyta nuk është marri të përmendet një rrënim, sepse i përmendi drejtori shumë rrënimë që janë bërë. Unë mandej po e pyes z. Shefkiu se a ka qenë përgjegjës së bashku me kolegun tënd për ndërtime pa leje? Për një vjet nuk ke dhënë përgjigje me shkrim për ndërtime pa leje të cilën kërkesa ta ka bërë kryetari i Komunës. Ne i dimë punët e drejtorit dhe kryetari i Komunës e ka dërguar lëndën në Komision disiplinor dhe ai Komision nuk ka dhënë vlerësim, sepse është shkarkuar.

Fehmi Sylejmani – z. Shefku e kuptova se ka leje, por unë e kam një pyetje të drejtpërdrejtë, sa kate do të ndërtohet ai objekt?

Valon Shefkiu- po i përgjigje z. Sylejmani dhe objekti të shkollat e mesme e ka lejen D – P +4 dhe atë do të ndërtohet me leje dhe Inspeksioni është duke e përcjell. Kryetari i Komunës i ka dëgjuar drejtorët në mbledhje të Këshillit, por ai i ka injoruar dhe nuk i ka dëgjuar kurrë sa vendime ka pasur dhe sa rrënimë ka pasur! Ai e ka pasur atë stil për t’i injoruar njerëzit për dallim nga kryetari i tanishëm që e ka një shkollë tjetër politike dhe drejtorët i ka shumë të përgjegjshëm dhe i dëgjon me vëmendje. Ndërtime ka pasur shumë pa leje dhe me përgjegjësi të plotë e them se të gjitha ato ndërtime kanë qenë të identifikuar dhe kryetari ka qenë i njoftuar për të gjitha ndërtimet që kanë ndodhur në Komunë, mirëpo nuk ka pasur vullnet për t’u marrë me këtë problematikë, sepse ai ka qenë kryesori!

Labinotë Demi –Murtezi – unë nga sektori i shëndetësisë do jap një përgjigje për anëtarin e Komitetit të Shëndetësisë nga PDK për zonjën Fatbardhë. Pyetja e saj është për kryetarin dhe ka të bëjë lidhur me kontratën me CARITASIN, por unë i kam dhënë përgjigjet dhe nëse ajo është e interesuar unë ia dorëzoj me shkrim.

Fatbardhë Selmani- unë bëra pyetje për kryetarin, por ai nuk është prezent, kurse për CARITASIN nuk kam nevojë, sepse i di !

Labinotë Demi Murtezi- pikërisht pse nuk janë të ngjashme me ato që unë i kam, desha të ofroj këtu përgjigje për hir të juaj dhe se Kontrata nuk ka qenë e nënshkruar me

CARITASIN Italian, por me atë të Kosovës. Kontratën e ka qenë e obliguar për kompensuar me mjete Zyra e Kryetarit dhe jo QKMF-ja. Si është shpenzuar. Komuna e Gjilanit është e vetmja Komunë që obligimet t i ka marrë me CARITASIN Kosovën i ka mbuluar QKMF-ja dhe jo Zyra e Kryetarit të Komunës! Këto edhe janë arsyet pse po ngec vazhdimi i Kontratës me CARITAS Kosovën. Kontrata me CARITAS Kosovën ka përfunduar, nuk është ndërprerë, por përtrirja e kësaj kontrate edhe pse është në interesin tonë nuk mund të bëhet, sepse përqindja e mundësisë së pagesës 80% me 20% në favor të Komunës 80% nuk na përshtate neve dhe aktualisht nuk kemi mjete për t' i mbuluar këto shpenzime. Dëshira dhe vullneti për t' u nënshkruar kjo kontratë është, por mundësitë materiale nuk janë.

Sa i përket veturave të QKMF-së i kanë në shfrytëzim si i kanë pasur dhe shpeshherë ne asistojmë me vetura tona tek ata. Ka pasur rast që një mjek për shfrytëzim të një veture na është drejtuar neve si drejtori dhe absolutisht nuk iu është marrë askujt vetura zyrtare. Sa i përket disa pagesave të cilat nuk i ka paguar drejtoria është aty ka pasur disa shpenzime ndoshta deri diku të arsyeshme, por që kanë qenë të muajit maj të vitit të kaluar! Mandej ka pasur raste kur është kërkuar shpenzime jo pak të vogla, prandaj për shpenzime më të mëdha duhet të konsultohet drejtori i Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Sociale dhe jo të vendos kokë në vete drejtori i QKMF-së.

Drejtori i QKMF-së vetë e ka pranuar Marrëveshjen për shkëputje të kontratës, ka qenë pozitë e karrierës pa afat dhe nuk është dhe nuk ka qenë e limituar si shembull deri në qershorin e vitit 2015 dhe ne e kemi ndërprerë. Ne me të vërtetë e kemi dërguar auditorin dhe vërtetë kanë dalë rezultate të mira, por ne e kemi respektuar drejtorin për ta bërë marrëveshjen, sepse vetë doktor Milazimi e ka parë të arsyeshme për ta liruar pozitën. Këto pyetje nuk ishin të drejtuara për mua, por e pata si përgjegjësi morale për ta dhënë këtë informatë Nëse ne e bëjmë kontratën me CARITAS Kosovën dhe i marrim shpenzimet përmes QKMF- së si ka qenë më parë, në QKMF do të mungojë sapuni për larje të duarve, nuk do të ketë renovim të ambulanteve për të cilat ankohet edhe drejtori dhe ish drejtori dhe secili qytetarë. Ne nuk mund t' i punësoj 12-20 punëtorë e që neve na konvenon, por që indirekt po humbet imazhi i shëndetësisë dhe punëtorëve shëndetësor po i mohohet e drejta e mundësisë edhe për mjete higjienike, kurse mos të flasim për gjëra të tjera.

Fatbardhë Selmani – është bërë një tejkalim për sa i përket terminologjisë sa i përket CARITASIT italian, apo Caritas Kosova, u tha nga drejtorja se janë ndërprerë kontratat dhe është e vërtetë se është ndërprerë kjo kontratë ndërmjet Caritasit dhe QKMF-së, por ajo mund të përtërihet. Pse bash tash po pretendohet të arrihet kontrata në me s Caritasit dhe juve, por unë kërkoja sqarim nga kryetari, por ju po i merrni kompetencat të përgjigjeni në pyetje të cilat ia kam drejtuar kryetarit. Po e ritheksoj edhe njëherë se përse drejtorit, shefit të QKMF-së, dr Valbom Milazimi e merr pagën e njëjtë ashtu siç e ka marrë kur ka qenë drejtor? Për këtë kërkoj sqarim edhe nga Zyra Ligjore se në çka është bazuar që shefi e merr pagën e njëjtë si të drejtorit. Gjithashtu derisa ju keni bërë një marrëveshje të tillë, kërkoj për ta ditur a është kjo në pajtim me ligjin? Po ashtu kemi informata se dr. Laurasit do t' i ndërrohet vendi i punës dhe do të dërgohet si shef në QKMF në Dardani.

Labinotë Demi- Murtezi - të jemi të qartë zonja Fatbardhë se shumë e njeriu ka ardhë deri te unë për të kërkuar punë dhe duke më thënë se më ka dërguar ky ose ai doktor i cili do të bëhet drejtor? Ju keni qenë në pozita edhe më parë, por për mua është hera e parë që e udhëheq një ekzekutiv. Është vërtetë se kryetari i Komunës e lë derën hapur

për qytetarë për të paraqitur ankesat dhe dertet e tyre. Mirëpo ta shfrytëzoj dikush emrin e një drejtori apo një partie vërtetë nuk e lejoj. Mund t' i marrë të dhënat e atij personi, mund të informohem për atë çështje, por kur të destinohen mjete për projekte, formohen komisione dhe i ndajmë ashtu si shpresoj dhe mendoj.

Për detajet e tjera unë e thash që në fillim po të ofroj këtë informatë. Kontratën me Caritasin e kam parë vetë është kontratë që ka përfunduar dhe nuk është ndërprerë dhe vetëm këtë detaj desha ta them. Ne po e shohim mundësinë e rishikimit të buxhetit dhe nëse mund ta mbulojmë, por kjo është padrejtësi që ne 80% të mjeteve t' i mbulojmë vetë, kurse në anën tjetër të mbetet meritë e Caritas Kosovës. Është mungesë e mjeteve dhe jo diçka tjetër.

Sokol Haziri- do të përpiqem të jap përgjigje pa përmendur emra. Lidhur me parku e Arbërisë është park që është finalizuar dhe i përket politikës tash për ta bërë destinimin. Mirëpo nëse është nevoja që t' i ndërrohet destinimi, ne mund të bëjmë debat me qytetarë, por do të përpiqem që të jetë një kujdestar aty si masë e përkohshme për ta mbrojtur nga qytetarët e pandërgjegjshëm. E dyta sa i përket trafikut urban, duhet përgatitur një debat dhe fillimisht KPF duhet të merret me këtë çështje sepse qyteti i Gjilanit ka nevojë për trafik urban për t' u liruar nga numri enorm i taksive.

Ujësjiellësi dhe kanalizim në lagjen "Resht Imeri" janë projekt i përbashkët i Shërbimeve Publike dhe Zyrës së Kryetarit e që do të jetë projekt gjithëpërfshirës. Ujësjiellësi kanalizimi dhe trotualet janë projekte të përbashkëta dhe presim bashkëpunimin e juaj.

Te varrezat e qytetit po përgjigjem kolegialisht, sepse pyetja nuk më është adresuar mua, por iu është drejtuar Zyrës së Prokurimit, por mund të them se në atë pjesë që e mbuloj unë është duke shkuar mirë puna. Qeverisja e kaluar e ka bërë bazën, shtrirjen e rrës, kurse tash po vazhdojmë me shtrirjen e kubzave e që është duke u bërë një punë shumë e bukur e që unë mendoj se do ta vlerësoj publiku shumë mirë. Çështja e prokurimit është e kësaj Zyre dhe unë nuk jap përgjigje për dike tjetër dhe që nuk më takojnë, por një gjë po iu them se unë nuk e di ku është Zyra e Prokurimit. Të dihet se punët po i bënë kompania e mëhershme e kontraktuar dhe jam i kënaqur me punën të cilën është duke e bërë. Pyetja për parkingjet, nga 1 qershori parkingjet kalojnë në menaxhim të Komunës. Rruga te Posta e Vogël në Dardani është një fyt tepër i ngushtë e të cilën çështje e kanë ngritur edhe më herët anëtarët e Kuvendit, por punën e parë që do ta vendosim tabelën për ndalim parkingu, pastaj është obligim i policisë së trafikut për t' i përcjell këto dukuri.

Te "Selami Hallaçi", pajtohem se është një projekt jo funksional, por tash do të përpiqemi që të bëjmë edhe një zgjidhje aty. Sa i përket çështjes së personelit në drejtori të ndryshme, unë e di se kjo është çështje e kryetarit të Komunës dhe ai është autoriteti kryesor, por drejtorja të cilën e menaxhoj unë nuk kam asnjë presion në kuptimin e punës së zyrtarëve, janë zyrtarë profesionistë dhe do të kenë masa eventuale vetëm nëse nuk zbatohen urdhrat dhe detyrat e punës dhe mbi asnjë bazë partiake nuk do të diskriminohet sa i përket drejtorisë përkatëse. Edhe njëherë iu falënderoj të gjithëve dhe po deklaroj se zyra e ime nuk do të jetë zyrë e AAK-së, por zyrë e drejtorit për shërbime publike dhe çdo qytetarë është i mirëseardhur për çfarëdo projekti.

Arben Maliqi- për mua problemi më i madh në Komunën e Gjilanit për një periudhë ishte problemi i ujit, por tash ujë ka mjaft, por tash është problemi tjetër, sepse gypat janë të amortizuar dhe të vjetër 35-40 vjet. Për këtë arsye po kemi shumë shpesh pëlcitje të qypave të ujit. Mirëpo ata të cilët po i mënjanojnë defektet po e presin asfaltin, po mbulohet me zhvar dhe po mbetet ashtu derisa të shpallet ndonjë tender tjetër. Mua më

intereson se a është obligim i Hidromoravës për ta sanuar atë rrugë, apo Drejtoria e Shërbimeve Publike? Ky është problem i rëndë dhe duhet marrë masa shpejtë, sepse do të ketë probleme të vazhdueshme në këtë aspekt. Është mirë që Drejtoria ta ketë parasysh që të intervenojë me kohë dhe të bashkëpunojë me kompaninë përkatëse.

Riad Rushiti- unë dëshiroj që ta bëj një pyetje, por ka qenë desh që të jetë prezent edhe zyrtari i Zyrës së Prokurimit ose ai i projekteve, por asnjëri nuk është i pranishëm. Kërkoj që në seancën e ardhshme të na përgjigjet me shkrim Zyra e Prokurimit për shkeljet ligjore, të na përgjigjet se si ka ndodhur kryerja e punëve pa nënshkrim të kontratës. Unë e di që aty është duke u punuar, por aty janë dy procedura të ndara. Traseja ka qenë e rregulluar, kurse sa i përket kubëzave e dimë që është një kompani e kontraktuar më herët, por tash është shpall një punë e re në atë rrugë që ka të bëjë me furnizimin e skajorëve të asaj rruge, por aty është punuar dhe pas përfundimit të punëve kanë filluar procedurat e prokurimit.

Sadullah Kadriu- unë edhe më herët e kam ngritur një problem te Drejtoria e Shërbimeve Publike, sepse ka pasur ankesa nga qytetarët lidhur me parkingjet për personat me aftësi të kufizuara e të cilat janë anuluar. Këso parkingje ka pasur para Shtëpisë së Mallrave dhe në Rrugë të Prishtinës, por tash nuk ekzistojnë. Kjo është një mangësi e madhe dhe patjetër duhet të caktohet një vend diku sa më afër qendrës së qytetit, sepse duhet ndihmuar dhe pasur kujdes për këta njerëz.

Sokol Haziri- është krijuar një bindje dhe qytetarët mendojnë se tërë këtë përgjegjësi për infrastrukturë si e përmendi z. Maliqi është përgjegjësi e Shërbimeve Publike. Në fakt ne bashkëpunojmë me Hidromoravën, por ajo nuk është vartësi tonën. Këtë problem e kemi pasur edhe në qeverisjen e kaluar dhe e kemi debatuar, por po theksoj se është një problem të cilit do t' i kushtohet vëmendje së bashku me kompaninë e cila bën investime dhe të ndryshohet hidro-struktura nëntokësore ose rrjeti i ujësjellësit të Gjilanit. Këtë e dinë të gjithë që është problem numër një. Sa i përket Hidromoravës si drejtor i Shërbimeve Publike i kam rezervat e mia problemet të cilat po bëhen në qytet janë të shkaktuara prej Hidromoravës dhe kthimin në gjendjen e mëparshme e ka për obligim kompania që i kryen punët.

Sa i përket krijimit të hapësirave për parkingje të personave me aftësi të kufizuara, unë jam i pajtimit që ata duhet të kenë qasje dhe me projektin që është në vazhdimësi për mirëmbajtje verore të rrugëve dhe trotuareve jo vetëm që do t' iu krijohej hapësirë personave me henidikep, jo vetëm që do të ketë parkingje speciale për ata, por do të kenë edhe qasje normale në trotuar.

Ismail Jonuzi- unë e kam përgatit një raport sa i përket Lumit Mirusha, sepse për këtë lumë e kisha një pyetje. Është i një raport i gjerë për këtë debat dhe në formë elektronike çdo anëtar i Kuvendit do t' ia dërgoj.

Mirëpo shkurtimisht po theksoj se është duke u kryer kanalizimi fekale i cili ka arrit te Çerdhja Ardhmëria dhe dihet se ky projekt është kontraktuar në vitin 2012 dhe deri më tash punët po kryhen me sukses, por me punë dinamike, sepse i ka kaluar të gjitha afatet kohore. Gjendja është e tillë dhe 25% e projektit ka përfunduar.

Sa i përket Konferencës së donatorëve, është një vërtetë se donacione po na vijnë mjaft dhe nuk e kemi parë të arsyeshme ta mbajmë një konferencë të tillë për shkak të gjendjes që është krijuar. Mirëpo unë besoj se do të mbahet ajo konferencë, sepse është Zyra e BE-së e cila me Ministrinë e Pushtetit Lokal, do ta vlerësojnë se kur do të jetë e

nevojshme për ta mbajtur këtë konferencë.

Ishte edhe një pyetje se kush po i përfiton tenderët, kompanitë vendore apo ato jashtë Gjilanit? ne si drejtori nuk kemi të drejtë të paragjykojmë dhe parashikojmë se kush dot a fitojë tenderin, sepse është e drejtë ligjore e çdo kompanie në Kosovë për të konkurruar, kurse përzgjedhja bëhet në bazë të ligjit. Mirëpo kryetari e ka thënë se tenderët nuk do të epen me dirigjim nga lartë, nga Qeveria apo person i lartë zyrtarë.

Mundësi ka që edhe kompanitë jashtë Gjilanit të marrin tenderë nëse është në pajtim me kriteret ligjore. Lidhur me trafikun urban projekti është i gatshëm dhe jemi duke i përgatitur edhe pikat e ndaljes së autobusëve.

Sahit Abazi- pasi që drejtori dha sqarime për Konferencën e donatorëve, por ndoshta unë e kam keqkuptuar se dikush e ka thënë se Konferenca e tillë shtyhet për shkak të afateve zgjedhore, por këtë konfirmoj tash drejtori. Konferencën e donatorëve e keni shtyrë dhe po e dëshmoni vetë dhe kjo është një ndër lajmet më të këqija të qeverisje së juaj! Arsyeja pse po e them se është një nga lajmet më të këqija është, sepse po lejoni një politizim të skajshëm të institucioneve. Do të duhej të kishte ndodhë kundërta dhe asnjë fushatë zgjedhore dhe asnjë element politik nuk do të guxonte ta ndal zhvillimin ekonomik nëse e keni me të vërtetë këtë çështje. Bindja ime është se ju nuk e keni fare vullnet për të qeverisur si duhet edhe pse keni dhënë shumë premtime. Për mua është sinjal i keq që Konferenca e donatorëve ndikohet nga politika ditore.

Riad Rashiti- unë kërkoj nga drejtori për Zhvillim Ekonomik që gjatë përgatitjes së informatës të na informojë edhe për Komisionin për vlerësimet e dëmeve që janë bërë gjatë të reshurave atmosferike. Të na informojë se cilat janë pengesat të cilat po ndikojnë në mos realizim të projektit të Mirushës, mandej a ka ndodhur ndryshimi i projektit pre qendrës e tutje, sepse që nga 24 dhjetori kur e ka filluar punën ko qeverisje për asnjë metër nuk ka lëviz puna në këtë projekt. Kërkoj për ta ditë a është shkaktar ndryshimi i projektit i cili po ndodh apo ka ndodh. Madje çka ka ndodh me kërkesën e juaj, për transferimin e mjeteve financiare, buxheti për këtë projekt nga Ministria përkatëse gjegjësisht a ka ndodhur ky transfer? Ne jemi informuar se 4 tenderë i ka dhënë Komuna e Gjilanit, kompanive jashtë Gjilanit, prej këtyre pak tenderëve dhe kjo nuk është për t' u kritikuar, sepse është ligji dhe nuk ka kriter që e favorizon një kompani vendore. Sa për informacion 4 kompani kanë marrë tender në Gjilan dhe njëra prej tyre është për blerje të biletave, sepse nuk ka pasur konkurrent të denjë në Gjilan për këtë rast.

Isa Agushi- nuk e kam të qartë pse vetëm në Gjilan po dashka të respektohet ligji! Urdhëroni dhe merreni një tenderë në Drenicë apo Llap nëse mundeni! Vetëm te ne duhet të respektohet ligji, prandaj për këtë arsyeje e kemi gjendjen kështu!

E dyta Konferenca e donatorëve duhet të mbahet me çdo kusht, pa marrë parasysh a janë zgjedhjet, a janë vërshimet, sepse ne kemi nevojë që të vijnë njerëzit dhe të investojnë në Komunën tonë. Unë nuk pajtohem në këtë rast me drejtorin.

Ismail Jonuzi- se sa është dikush i kënaqur në përgjigjet tona varet se kush si i kupton gjërat, por ne duhet t' i respektojmë procedurat për dhënie të tenderit. Ne nuk i bëjmë përgatitjet dhe nuk ia përshtatim dikujt tenderin si në të kaluarën dhe janë një mori faktesh që dokumentojnë se tenderët janë përgatitur për kompani të caktuara dhe që janë dirigjuar nga lartë. Ne nuk po merremi me të kaluarën, por do të punojmë për të ardhmen dhe nuk mund të paragjykojmë edhe pse dëshira është për t' i dhënë punë kompanive gjilanasë, por vetëm në pajtim me ligjin dhe kriteret e prokurimit.

Sa i përket Mirushës e mora për sipër për t'iu informuar në detale nëpërmes adresave elektronike dhe aty do të njoftoheni edhe për revidim të projektit.

Konferenca e donatorëve nuk varet prej neve, por nga Zyra e BE-së dhe kjo vendim-marrje është marrë pa vullnetin tonë. Ne si drejtori komunale i kemi bërë të gjitha përgatitjet dhe të gjitha projektet për një konferencë të donatorëve, por kjo nuk është varë nga ne, sepse është vetë Zyra e BE-së e cila i ka pesë regjione në nivel të Kosovës. Njëra nga këto zyre është edhe Regjioni i Gjilanit dhe tendenca ka qenë që Konferenca e parë e donatorëve të mbahet në Gjilan, por nuk është mbajtur pa vullnetin dhe dëshirën tonë dhe vendimmarrja a do të mbahet Konferenca e donatorëve apo jo nuk është çështje e jonë.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- z. Nevzadi ka parashtruar pyetje pse Nezahate Agushi i takon KTDP-së? Përgjigja është se zonja Nezahate është e martuar për një pjesëtar të komunitetit turk dhe këtu nuk ka asgjë të keqe dhe kjo është bërë në marrëveshje me kryetarin e KTDP-së!

Sa i përket z. Kadriu pyetjen që e bëri komisionin për bursa, ne në Kuvend e kemi marrë një vendim për përfaqësimin e partive politike në bazë të ulëseve dhe e kemi thënë se partitë e vogla duhet të pajtohen dhe ta dërgojnë një emër. Mirëpo kjo nuk vlen për Komisionin për bursa, sepse është votuar këtu dhe është aprovuar në Kuvend.

Në fund po iu njoftoj se tërë seanca e Kuvendit është transmetuar në projektorin i cili është vendosur para Teatrit të Qytetit.

Sadri Arifi- sa i përket llap –topëve të gjithë ish anëtarët e Kuvendit kanë qenë të furnizuar me llap-top, mirëpo aktualisht nuk ka mjete për këtë periudhë, por në 6 mujorin e dytë kemi premtime dhe do të pajisen edhe anëtarët e tjerë që nuk posedojnë llap –top.

Me këto vendime dhe debate seanca e shtatë e KK-së përfundoi punimet në ora 15.30 min.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjku- Rexhepi